



Australian Government

Department of Immigration and Citizenship

Fillimi i Jetës në Australi

Mirëse Vini në

New South Wales

Shqip
Albanian

Janar 2009

Data e botimit: Janar 2009

Numrat e telefonit: Numrat e telefonit që fillojnë me 1800 janë thirrje falas në se thërrisni nga një linjë private dhe kushtojnë sa një telefonatë lokale në se thërrisni nga telefonat publikë. Numrat që fillojnë me 13 ose 1300 kushtojnë sa një telefonatë lokale. Disa numra 1300 dhe 1800 mund të përdoren vetëm nga jashtë kryeqytetit. Thirrjet nga telefonat celular u përmbahen kostove të telefonave celularë.

Për numrat që nuk fillojnë me 13, 1300 ose 1800: Nëse telefononi nga jashtë Australisë, bjeri prefiksit 61, pastaj kodit të qytetit pa 0-n, dhe pastaj numrit. Nëse telefononi brenda Australisë por jashtë shtetit ose territorit, bjeri kodit të qytetit, pastaj numrit.

Përgjegjësitë: Megjithëse Department of Immigration and Citizenship (Departamenti) dhe bashkëpunëtorët e tij janë përpjekur që materiali i shënuar në këtë broshurë të jetë sa më i saktë në kohën e publikimit, broshura përmban një sërë temash të cilat mund të ndryshojnë rregullisht. Departamenti apo bashkëpunëtorët e tij nuk mbajnë përgjegjësi për neglizhencë, në se dikush vuan apo pëson humbje si rezultat i zbatimit të informacionit të dhënë në këtë broshurë.

Përmbajtja

| | |
|--|-----------|
| Parathënie | 5 |
| 1. Çfarë duhet të bëni së shpejti pas mbërritjes | 6 |
| A. Bëni kërkesë për Tax File Number (Numrin e Taksës) | 6 |
| B. Regjistrohuni në Medicare dhe mendoni rreth mundësisë së shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore private (kundrejt një shume, paguar rregullisht kompanisë së siguracionit) | 7 |
| C. Hapni një llogari bankare | 7 |
| D. Regjistrohuni me Centrelink (Shërbimin Social) | 8 |
| E. Kontaktoni Shërbimin e Garancisë së Shëndetit | 8 |
| F. Regjistrohuni në kurset e Gjuhës Angleze | 9 |
| G. Regjistroni fëmijët tuaj në një shkollë | 9 |
| H. Aplikoni për patentën e shoferit | 9 |
| 2. Ndhmë me Anglishten | 11 |
| Mësimi i Gjuhës Angleze për të Rriturit | 11 |
| Shërbimet e përkthimeve me gojë dhe me shkrim | 13 |
| 3. Shërbimet e Urgjencës | 15 |
| Policia | 15 |
| Ambulanca | 15 |
| Brigada e Zjarrfikësave | 16 |
| Numra të tjerë të urgjencave | 16 |
| 4. Ku të shkoni për ndihmë | 17 |
| Qendrat Përkrahëse për Emigrantë dhe Agjensitë e Shërbimit për Emigrantë | 17 |
| Adult Migrant English Program (AMEP) (Programi i Anglishtes për Emigrantët e Moshës së Rritur) | 19 |
| Organizatave etnike dhe të komunitetit | 19 |
| Shërbimet për të rinjtë | 20 |
| Ndihma Ligjore | 20 |
| Dhuna | 21 |
| Të Drejtat e Konsumatorit | 21 |
| Këshillat Lokale | 22 |
| The Australian Government Regional Information Service (AGRIS) | 23 |
| Lehtësim në rast Urgjence | 23 |
| Gjetja e të afërmeve | 23 |
| Telefoni për këshillim në kriza | 23 |
| Martesa dhe marrëdhënjet e tjera të afërta | 24 |
| Këshillime për njerëz që janë torturuar dhe traumatizuar | 24 |
| Shërbimet Financiare | 24 |
| Tax Help (Ndhmë për Taksën) | 26 |
| 5. Ligji dhe zakonet Australiane | 27 |
| Përgjegjësitë dhe vlerat | 27 |
| Barazia dhe qëndrimi kundra diskriminimit | 27 |
| Shkeljet e Kodit Penal- Krimet | 28 |
| Drejtimi i Automjeteve | 30 |
| Droga, duhani dhe pijet | 31 |
| Mjedisi | 32 |
| Zhurma | 32 |
| Kafshët | 32 |
| Takimi dhe komunikimi me njerëzit | 33 |
| Sjellja e hijshme | 33 |
| Veshja | 33 |
| Shprehje të përditshme Australiane | 34 |

| | |
|---|-----------|
| 6. Strehimi..... | 35 |
| Qiramarrja e shtëpive private ose apartamenteve | 35 |
| Të drejtat dhe përgjegjësitë e qiraxhinjëve..... | 36 |
| Blerja e shtëpive private ose apartamenteve | 37 |
| Strehimi nga Qeveria..... | 37 |
| Strehimi I Përkohshëm Urgjent | 38 |
| Supported Accommodation Assistance Program..... | 38 |
| Linja Telefonike për të Rinjtë që Kërkojnë Strehim Urgjent..... | 39 |
| Shërbimet shtëpijake të Domosdoshme..... | 39 |
| 7. Punësimi | 41 |
| Kërkimi i punës..... | 41 |
| Job Network services (shërbime të Rrjetit të punës)..... | 41 |
| Më shumë informacion | 42 |
| Kualifikimet..... | 42 |
| Kushtet e punës (të drejtat e punëdhënësit/ punonjësit)..... | 44 |
| Superannuation (Pagesat e Detyruara nga Punëdhënësi për Pensionim)..... | 45 |
| Taksimi..... | 45 |
| 8. Sigurimi social..... | 48 |
| Pagesat e Centrelink | 48 |
| Periudhat e pritjes | 48 |
| Family Assistance payments (Pagesat që ndihmojnë familjet me koston e rritjes së fëmijëve)..... | 49 |
| Moshat e reja | 50 |
| Dikush të merret me Centrelink ose Family Assistance Office për ju..... | 50 |
| Dikush të merret me entrelink për ju | 50 |
| Të Drejtat dhe përgjegjësitë | 50 |
| Nëpunësit e Shërbimit Shumëkulturor Centrelink | 51 |
| Më shumë informacion | 51 |
| 9. Transporti | 53 |
| Transporti Publik | 53 |
| Automjetet private | 54 |
| 10. Arsimi dhe çerdhet..... | 56 |
| Çerdhet | 56 |
| Shkollat | 56 |
| Fëmijët që nuk flasin Anglisht..... | 57 |
| Përkthyesat | 57 |
| Regjistrimi..... | 57 |
| Arsimi Profesional | 58 |
| Universitetet | 58 |
| 11. Sistemi Shëndetësor..... | 59 |
| Medicare | 59 |
| Centrelink Health Care Card (Karta e Kujdesit për Shëndetin e Centrelink)..... | 59 |
| Sigurimi Shëndetësor Privat..... | 59 |
| Ndihma Mjekësore | 60 |
| Qendrat Shëndetësore të Komunitetit..... | 61 |
| Shëndeti Mendor | 61 |
| Shërbimet për njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore dhe gjuhësore..... | 61 |
| Imunizimi (Vaksinimi) | 62 |
| Shërbimet Stomatologjike | 62 |
| Më shumë informacion | 63 |
| 12. Argëtimi dhe Media | 64 |
| Aktivitetet në natyrë..... | 64 |
| Media | 64 |
| Interneti | 65 |

| | |
|---|-----------|
| 13. Departamenti i Emigracionit dhe Nënshetësisë | 66 |
| Nënshetësia Australiane | 66 |
| Vizat e kthimit për banorët..... | 67 |
| Vizitat Familjare në Australi..... | 67 |
| 14. Shërbimet e qeverisë dhe komunitetit Lokal | 68 |
| Shërbimet e Komunitetit | 68 |
| Shërbime Multikulturore | 68 |
| Bibliotekat..... | 68 |
| Shërbime të tjera | 68 |
| Më shumë informacion | 68 |

Parathënie

Mirëse erdhët në Australi dhe veçanërisht në New South Wales.

Qeveritë Australiane, të Shteteve, Territoreve dhe ato Lokale të Australisë, së bashku me agjensitë joqeveritare u sigurojnë banorëve Australianë një sërë shërbimesh. Kjo broshurë ju jep informacion lidhur me llojet e shërbimeve dhe ndihmën që ju jepet, dhe se ku mund të shkoni dhe të merrni këshilla.

Kjo broshurë i drejtohet të gjithë emigrantëve të ardhshëm dhe atyre të sapoardhur në Australi me një fokus të veçantë në emigrantët e përhershëm dhe atyre që hyjnë për arsye humanitare si dhe sponsorizuesave tyre dhe siguruesave të shërbimeve. Refugjatët dhe personat e hyrë për arsye humanitare duhet t'i përmbahen edhe informacionit të dhënë posaçërisht për ato nga Department of Immigration and Citizenship (Departamenti i Emigracionit dhe Nënshitetësisë) (DIAC).

Është shumë e vështirë ta bësh të mundur që i gjithë informacioni në broshurë t'ju përshtatet të gjithë lexuesve. Është e rëndësishme të keni parasysh që disa emigrantë të përhershëm dhe shumica e atyre që mbajnë viza të përkohshme mund të mos jenë të ligjshëm për të gjitha shërbimet.

Ju lutemi të gjeni kohë dhe ta lexoni këtë broshurë me kujdes. Ne besojmë se do t'ju ndihmojë ndërkohë që filloni jetën tuaj të re në Australi. Ju duhet të përdorni botimin më të fundit, që gjendet në shumicën e zyrave të shërbimeve të vendosjes dhe nga faqet e internetit 'Living in Australia' (Jetesa në Australi) www.immi.gov.au/living-in-australia. Ne ju sugjerojmë që në fillim të lexoni Kapitujt 1-4. Ato merren me çështjet e rëndësishë së veçantë që lindin gjatë javëve të para të qëndrimit.

Problemet që do t'ju duhet të përballoni ndërkohë që filloni jetën tuaj të re në Australi janë komplekse dhe në ndryshim. Do të ketë sfida por edhe shpërblime. Në fund, suktesi juaj do të varet nga vetë përpjekjet tuaja si dhe nga vullneti i atyre që dëshirojnë t'ju ndihmojnë. Mirëse erdhët dhe fat të mbarë!

1. Çfarë duhet të bëni së shpejti pas mbërritjes

Më poshtë është lista e 8 gjërave të rëndësishme që duhet të bëni sa më shpejt që të jetë e mundur pas mbërritjes në Australi . Shënojeni me ✓ pasi ti keni bërë.

| | |
|--|--------------------------|
| Lista e kontrollit | ✓ |
| A. Bëni kërkesë për Tax File Number (Numrin e Taksës) | <input type="checkbox"/> |
| B. Regjistrohuni në Medicare dhe mendoni rreth mundësisë së shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore private | <input type="checkbox"/> |
| C. Hapni llogari bankare | <input type="checkbox"/> |
| D. Regjistrohuni në Centrelink (Shërbimin Për Ndihma Sociale) | <input type="checkbox"/> |
| E Kontaktoni Shërbimin e Garancisë së Shëndetit | <input type="checkbox"/> |
| F. Regjistrohuni në kurset e Gjuhës Angleze | <input type="checkbox"/> |
| G. Regjistroni fëmijët tuaj në një shkollë | <input type="checkbox"/> |
| H. Aplikoni për patentën e shoferit | <input type="checkbox"/> |

Për informacion lidhur me shërbimet e përkthimit dhe për njohuri se ç'duhet bërë për të përkthyer dokumente, shihni Kapitullin 2, Ndihmë me Anglishten.

Për informacion rreth organizatave që mund t'ju ndihmojnë në lidhje me çështjet e stabilizimit tuaj shihni Kapitullin 4, *Where to go for help* (Ku të shkoni për ndihmë).

A. Bëni kërkesë për Tax File Number (Numrin e Taksës)

Më përpara bëni këtë gjë. Për të marrë të ardhura në Australi keni nevojë për **Tax File Number (TFN)**. Të ardhurat përfshijnë rrogën nga punësimi, pagesat nga qeveria, dhe paratë e fituara nga investimet duke përfshirë interesat e marra nga llogaritë e kursimeve.

Si të aplikoni për një tax file number (numër takse)

Në Australi ju mund të telefononi **Australian Taxation Office (ATO)** dhe t'ju kërkoni t'ju dërgojnë një formular aplikimi. Përndryshe, mund të aplikoni për TFN në faqen e internetit të ATO gjatë 24 orëve të ditës, 7 ditët e javës. Formularët janë të vlefshëm edhe në zyrat e ATO ose **Centrelink**, të cilat janë të rreshtuara në librin telefonik White Pages (Faqet e Bardha).

Të dhënat e kontaktimit të Australian Taxation Office (ATO)

| | |
|--------------------------------|---|
| Telefoni | 13 2861 |
| Aplikoni për TFN online | Online individual TFN registration |
| Në person | ATO shopfront locations Centrelink shopfront locations |
| ATO website | www.ato.gov.au |

Për më shumë informacion mbi Taksimin, shikoni Kapitullin 7, Punësimi.

B. Regjistrohuni në Medicare dhe mendoni rreth mundësisë së shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore private (kundrejt një shume, paguar rregullisht kompanisë së siguracionit).

Qeveria Australiane ju ndihmon me shpenzimet mjekësore përmes një skeme që quhet **Medicare**. Qeveria gjithashtu subvencionon koston e shumicës së ilaçeve nën Skemen e Përfitimeve Farmaceutike (PBS). Medicare dhe PBS administrohen nga Medicare Australia.

Ju mund të keni të drejtë që të regjistroheni në Medicare dhe të shfrytëzoni menjëherë shërbimet dhe programet mjekësore si shërbimet spitalore falas, ndihmën me shpenzimet e kujdesit jashtë-spitalor dhe mjekimet e subvencionuara. Është e rëndësishme ta dini që jo të gjithë emigrantët janë të ligjshëm për ndihmë Medicare (Mjekësore) dhe ju duhet të kontaktoni Medicare për tu informuar nëse jeni i/e ligjshëm.

Medicare ka një **Information Kit** (Broshurë Informacioni), e cila është e përkthyer në 19 gjuhë të ndryshme dhe është e vlefshme në Anglisht, në Gjuhën e të Verbërve dhe në CD dhe kasetë. Ajo ju shpjegon për shërbimin Medicare dhe shërbimet e tjera shëndetësore të qeverisë si dhe kriteret e pranimit për përfitime dhe pagesa. Mbani mend që ta kërkonti materialin informativ kur shkoni në zyrën lokale të Medicare, Migrant Resource Centre (Qendra Burimore e Emigrantëve) ose vizitoni faqen e internetit.

Si të regjistroheni me medicare

Për t'u regjistruar në Medicare, ju duhet të shkoni në zyrën e Medicare 7 deri në 10 ditë pas ardhjes në Australi dhe sillni me vete pasaportën tuaj, dokumentet e udhëtimit dhe vizën e përherëshme. Nëse plotësohen të gjitha kriteret e regjistrimit, mund t'ju jepet numri i kartës Medicare për ta përdorur derisa karta të arrijë me postë brenda 3 javëve. Në shumicën e rasteve ju duhet të paguani për kujdesin mjekësor dhe pastaj do t'ju paguhet prapa për një pjesë të pagesës. **Nëse keni nevojë të shikoni një doktor urgjentisht**, ju mund të regjistroheni me Medicare pa prituri të plotësohet 7 deri 10 ditëshi dhe kërkonti një numër të përkohshëm.

Emergency treatment (Mjekimi në rast urgjence) është i vlefshëm 24 orë në departamentet e 'Casualty' (Plagosjeve) ose 'Emergency' (Urgjencës) të spitaleve publike.

Të dhënat e kontaktimit të Medicare

Telefoni **13 2011**

Në person [Zyrat e Medicare](#)

Broshura e Informacionit e Medicare [Broshura e Informacionit](#)

(e vlefshme në gjuhë të tjera përveç Anglishtes)

Medicare website www.medicareaustralia.gov.au

Përveç Medicare ka gjithashtu shumë fonde të tjera private sigurimi shëndetësor që ofrojnë mundësi për të mbuluar shërbimet që nuk mbulohen nga Medicare si p.sh. kujdesi dentar, shumica e shërbimeve të kujdesit të syve dhe transporti me ambulancë.

Për më shumë informacion rreth sigurimit privat të shëndetit shikoni Kapitullin 11, *The health system (Sistemi i Shëndetësisë)*

C. Hapni një llogari bankare

Në Australi, njerëzit i mbajnë paratë nëpër banka, shoqëri ndërtimore apo unione kreditore. Shumica e të ardhurave duke përfshirë rrogat dhe përfitimet nga qeveria paguhet direkt në një llogari banke. Australianët përdorin karta bankare dhe karta krediti për shumë qëllime.

Është e këshillueshme të hapni një llogari bankare **brenda 6 javëve pas ardhjes suaj**, për arsye se zakonisht do t'ju duhet vetëm pasaporta si dokument identifikimi. Pas 6 javësh, që

të hapni një llogari bankare do t'ju duhen dokumente të tjera shtesë, dhe mund ta keni të vështirë nëse ju nuk keni shumë dokumenta të tjera. Jepini bankës suaj Numrin e Taksës (TFN) që të evitoni tarifat e larta të taksimit mbi interesin e fituar.

Për më shumë informacion mbi hapjen e një llogarie bankare shkoni në website më poshtë.

[Smarter Banking – si të fitosh më shumë nga paratë tuaja](http://www.bankers.asn.au) www.bankers.asn.au

D. Regjistrohuni me Centrelink (Shërbimin Social)

Centrelink, një agjensi qeveritare ju jep ndihmë për të kërkuar punë, jep pagesat e sigurimit social si dhe ndihma të tjera. Banorët e sapoardhur mund të regjistrohen me Centrelink për të marrë ndihmë kur kërkojnë punë, për të gjetur ndihmë në njohjen e kualifikimeve joaustraliane (d.m.th. kualifikimet e fituara në atdhe e gjetkë) si dhe për t'u futur në kurset e duhura (përkatese). Centrelink gjithashtu ka formularë aplikimi për Tax File Number (Numër Takse) dhe mund t'ju asistojë që ta dorëzoni atë në Zyrën e Taksave, me qëllim që të mos vonohet e drejta për pagesat tuaja. Pagesat mund të bëhen që nga dita që ju kontaktoni Centrelink-un. Që të paguaheni që nga dita e mbërritjes suaj në Australi ju duhet të bëni kontakt atë ditë dhe të fusni lutjen brenda 14 ditëve.

Personat që kanë hyrë për arsye humanitare janë të ligjshëm për Crisis Payment (Pagesë në Rast Krize) nga Centrelink. Personi duhet ta kërkojë këtë pagesë brenda 7 ditëve të mbërritjes në Australi ose të kontaktojë Centrelink dhe të njoftojë se synon ta kërkojë pagesën brenda 7 ditëve të mbërritjes dhe e dorëzon lutjen brenda 14 ditëve të këtij kontaktimi. Për më shumë informacion shikoni Kapitullin e 8, *Social Security*.

Nëse keni fëmijë, ju do të mund të keni të drejtë që të merrni pagesa të sponsorizuara nga qeveria për familjet si ndihmë kundrejt shpenzimeve të rritjes së fëmijëve.

Për më shumë informacion shih Kapitullin 2, *Ndihmë me Anglishten*, Kapitullin 7, *Punësimi* dhe Kapitullin 8, *Sigurimi social*.

Të dhënat e kontaktimit të Centrelink

Telefoni 13 1021

Ndihmë me gjuhët jo Anglisht 13 1202

Në person [Zyrat e Centrelink](#)

Website i Centrelink www.centrelink.gov.au

Për emigrantët e sapoardhur [A keni ardhur kohët e fundit për tu vendosur në Australia](#)

Informacion në gjuhë të tjera [Ndihma e Centrelink – ne flasim gjuhën tuaj](#)

E. Kontaktoni Shërbimin e Garancisë së Shëndetit

Nëse keni nënshkruar një Formular të **Garancisë së Shëndetit** (Formulari 815) me kërkesën e Department of Immigration and Citizenship (DIAC) jashtë shtetit, ju duhet të telefononi Shërbimit të Garancisë së Shëndetit pasi të keni mbërritur në Australi.

Pasi të kontaktoni Shërbimin e Garancisë së Shëndetit, ato do t'ju tregojnë për Klinikën Shëndetësore më të afërt ku mund t'i kryeni kontrollet tuaja.

Health Undertaking Service 1800 811 334

(9 paradite – 4 pasdite, Të Hënën deri të Premten)

F. Regjistrohuni në kurset e Gjuhës Angleze

Komunikimi në Anglisht është shumë me rëndësi dhe çelësi i vendosjes tuaj të suksesshme. Nëse nuk flisni Anglisht, e rekomandajmë me të madhe që të mësoni sa më shpejt që të jetë praktike pasi të mbërrini.

Kurset e mësimi të gjuhës angleze për të sapoardhurit në Australi jepen nga **Adult Migrant English Program (AMEP)** (Programi i Gjuhës Angleze për Emigrantët e Moshës së Rritur). Si banor i ri ju mund të keni të drejtë që të merrni 510 orë të mësimi të gjuhës Angleze falas. AMEP ofron një numër mundësish në mënyrë që ju të mësoni Anglisht nëse ju punoni ose keni detyrime të tjera familjare.

G. Regjistroni fëmijët tuaj në një shkollë

Sipas ligjit Australian, fëmijët mes moshës 5 deri në 15 vjeç duhet të shkojnë në shkollë. Ju duhet t'i regjistroni fëmijët në shkollë sa më parë që të jetë e mundur. Për më shumë informacion shihni Kapitullin 10, Education and child care (Arsimimi dhe Çerdhet//Kopshtet).

H. Aplikoni për patentën e shoferit

Nëse jeni mbajtës/e i një vize për banor/e të përhershëm/e dhe keni patentë të vlefshme shoferi nga një vend tjetër, në Gjuhën Angleze apo të përkthyer zyrtarisht nga një burim i pranueshëm, ju keni të drejtë të drejtoni automjete për 3 muajt e para pas mbërritjes tuaj në Australi. Më pas nëse doni të drejtoni automjete duhet të merrni patentën përkatëse Australiane. Kjo zakonisht do t'ju kërkojë të kaloni testin teorik, praktik si dhe kontrollin e syve për të konstatuar aftësinë e shikimit. Në Australi patentat e drejtimit të automjeteve lëshohen nga qeveritë e shtetit dhe territorit.

Nëse nuk keni një patentë nga një vend tjetër ju duhet të kaloni një Test Teorie për Shoferat për të marrë një leje nxënësi.

Të gjithë aplikantët për leje duhet:

- ta paraqesin tek **Road Traffic Authority (RTA)** (Autoriteti i Rrugëve dhe Trafikut) nëse kanë leje makine nga jashtë shtetit (me një përkthim zyrtar që mund të fitohet ose nga Community Relations Commission (Komisioni i Marrëdhënieve të Komunitetit) ose nga Department of Immigration and Citizenship (Departamenti i Emigracionit dhe Nënshitetësisë).
- të japin provë të identitetit të tyre për të plotësuar kërkesat e RTA
- të japin provë të adresës së tyre në NSW
- të kalojnë një Driver Knowledge Test (me përjashtim të rasteve kur nuk kanë nevojë ta bëjnë testing)
- të kalojnë një test praktik për makinat ose motorçikletat (me përjashtim të rasteve kur nuk kanë nevojë ta bëjnë testing)
- të kalojnë një test shikimi
- të paguajnë pagesën e kërkuar (me përjashtim të rasteve kur nuk kërkohet të paguajnë)

Vendet që njihen

Mbajtësit e një leje automjeti apo motorç/iklete e lëshuar nga një prej vendeve të mëposhtme përjashtohen nga testimi teorik dhe praktik i drejtimit të automjetit kur aplikojnë për një leje të njëjtës kategori në NSW:

Austria
Belgjika
Canadaja
Kroacia
Danimarka
Finlanda
Franca
Germania
Greqia
Guernsey
Irlanda
Isle of Man (lejet e lëshuara nga **1 Prilli 1991**)
Italia
Japonia
Xhersi

Luksemburgu
Malta (lejet e lëshuara nga **2 Janari 2004**)
Hollanda
Zelanda e Re ([më shumë informacion](#))
Norvegjija
Portugalia
Singapori
Spanja
Suedia
Zvicra
Anglia
SHBA

Prova e identitetit dhe kërkesat shpjegohen në broshurën **How to prove who you are to the RTA** (Si t'ia provoni RTAsë se kush jeni) që mund ta merrni nga zyrat e RTA.

Për më shumë informacion në lidhje marrjen e lejes së makinës vizitoni faqen e internetit të **Roads and Traffic Authority (RTA)** (Autoriteti i Rrugëve dhe Trafikut) www.rta.nsw.gov.au/licensing/index.html ose thërrisni:

Nëse jeni mbajtës i një vizë të përkohëshme, për më shumë informacion ose për të mësuar rreth drejtimit të automjetit, vizitoni faqen e internetit të **Roads and Traffic Authority** (Autoriteti i Rrugëve dhe Trafikut) (RTA) www.rta.nsw.gov.au/licensing/index.html ose thërrisni:

RTA (general enquiries)

13 2213

RTA website

www.rta.nsw.gov.au

Ju lutemi vini re: Australia ka ligje strikte për trafikun dhe nisjen e makinës nën ndikimin e alkoolit, të cilave ju duhet t'u përmbaheni. Për më shumë informacion shihni Kapitullin 5, *Australian customs and law* (ligji dhe zakonet Australiane).

Shikoni Kapitullin 2, *Help with English* (Ndihmë me Anglishten) për përkthimin e zyrtarizuar të patentës së shoferit.

2. Ndhimë me Anglishten

Mësimi i Gjuhës Angleze për të Rriturit

Programi Adult Migrant English (AMEP)

Një nga hapat e parë dhe më të rëndësishëm që mund të merrni në drejtim të vendosjes së suksesshme në Australi dhe arritjen e qëllimeve të tuaja është mësimi i Anglishtes. Nëse ju jeni të ligjshëm, AMEP mund t'ju japin mësimet fillestare të gjuhës Angleze që do t'ju ndihmojë të merreni me situatat shoqërore dhe disa situata pune.

Nëse ju plotësoni kushtet për AMEP ju mund të mësoni Anglisht deri në 510 orë, ose derisa të mbërrini një nivel funksional të Anglishtes, cilado që vjen e para. Nëse ju jeni një person i hyrë për arsye humanitare që ka pasur eksperiencë të vështira si tortura ose trauma para se keni ardhur në Australi, ose keni kryer shumë pak arsim zyrtar, ju mund të keni të drejtë për më shumë mësim Anglishte.

Është e nevojshme të testohen aftësitë e të folurit, leximit, shkrimit dhe dëgjimit Anglisht për të shikuar nëse kualifikoheni për klasat e AMEP. Nëse Anglishtja juaj nuk është testuar jashtë shtetit si pjesë e aplikimit për emigrim, do të testohet kur të regjistroheni për klasat e AMEP-it në Australi.

Ju duhet të regjistroheni për klasat e AMEP-it me siguruesin lokal të shërbimit të AMEP-it brenda tre muajve të ardhjes në Australi ose të fitimit të qëndrimit të përhershëm. Ju duhet të filloni klasat brenda një viti ose ka mundësi që nuk mund të mësoni Anglisht me AMEP. Pasi të regjistroheni, ka mundësi që ta shtyni fillimin e klasave të Anglishtes nëse përgjegjësitë tuaja familjare, të punës ose të tjera e bëjnë të vështirë për ju të shkoni në shkollë.

AMEP ofron një numër mënyrash të ndryshme për të mësuar. Ju mund të shkoni në shkollë çdo ditë ose më pak, ditën, natën ose në fundjavë. Mësimet zhvillohen në qytete dhe fshatra. Ju mund të mësoni Anglisht në shtëpi nëpërmjet Distance Learning (Mësimi në Distançë) ose me ndihmën e një mësuesi në shtëpi. Nëse keni fëmijë nën moshën e shkollës siguruesi i shërbimit mund të organizojë kujdes falas për fëmijë gjatë kohës që ju jeni në mësim.

Enquiries Line

131 881

AMEP website

www.immi.gov.au/amep

Settlement Services Locator

www.immi.gov.au/living-in-australia/settle-in-australia/find-help/where-to-help/index.htm

Nëse ju pëlqen të regjistroheni ose të gjeni nëse jeni të ligjshëm për AMEP kontaktoni siguruesin më të afërt të shërbimit (të shënuara më poshtë).

**South Western Sydney region of NSW
Fairfield, Cabramatta and Liverpool**
ACL Fairfield
6-8 Alan Street
FAIRFIELD NSW 2165
Tel: **(02) 9723 4244** or **1300 798 111**
Fax: (02) 9723 6444
Email: amepenquiry@acl.edu.au
Web: www.acl.edu.au

Inner City and Eastern Sydney region of NSW
NSW AMES
84-86 Mary Street
SURRY HILLS NSW 2010
Tel: **(02) 9289 9111**
Fax: (02) 9281 9995
Email: innercity@ames.edu.au
Web: www.ames.edu.au

**Western Sydney region of NSW
Auburn, Parramatta, Blacktown**
ACL Auburn

Burwood, Hornsby, Newcastle and Rural NSW region of NSW
NSW AMES

3 Mary Street
AUBURN NSW 2144
Tel: **(02) 9749 3300** or **1300 798 111**
Fax: (02) 9749 3310
Email: amepenquiry@acl.edu.au
Web: www.acl.edu.au

29-31 Belmore Street
BURWOOD NSW 2134
Tel: **(02) 9744 3885**
Fax: (02) 9744 3815
Email: burwood@acl.edu.au
Web: www.ames.edu.au

**Southern Sydney and Illawarra
region of NSW**
NSW AMES
2 Jacobs Street
BANKSTOWN NSW 2200
Tel: **(02) 9205 4350**
Fax: (02) 9793 9541
Email: bankstown@ames.edu.au
Web: www.ames.edu.au

Migrant Resource Centre (Qendra juaj Për Përkrahje Për Emigrant), (shihni Kapitullin 4, *Where to go for help* (Ku të shkoni për ndihmë)), dhe Centrelink-u (shih Kapitullin 7, *Employment*) mbajnë informacion për AMEP si dhe për mënyra të tjera për të përmirësuar gjuhën Angleze.

Mundësitë e tjera për të mësuar anglisht

Mësimi i gjuhës Angleze është i vlefshëm gjithashtu nëpërmjet programeve të specializuara të drejtuara nga Departamentet e Arsimit, Employment and Workplace Relations (Punësimit dhe Marrëdhënieve të Punës) (DEEWR) dhe qeveritë e shtetevëteritoreve. DEEWR ka 2 programe gjuhe për të rriturit e moshës së punës (15-64 vjeç) në lidhje me punësimin.

I pari është **Language, Literacy and Numeracy Program (LLNP)** (Program i Gjuhës, Leximit dhe Numrave) që siguron deri në 800 orë trainimi të gjuhës, leximit dhe numrave për ato që kanë vështirësi në gjetjen e punësimit si pasojë e pengesave të shkaktuara nga niveli i ulët i leximit ose gjuhës Angleze.

Ju mund të jeni të ligjshëm për LLNP nëse keni kryer kursin e AMEP ose edhe nëse nuk ju takon ligjshërisht përfshirja në AMEP. LLNP përfshin shkrim, bisedim, dëgjim, lexim, matematikë dhe mësim zanati në gjuhën Angleze për t'ju ndihmuar që të gjeni punë. Që t'ju takojë ligjshërisht ky program duhet të regjistrohemi me **Centrelink** si Person që Kërkon Punë.

Centrelink **13 1021**

Nëse nuk flisni Anglisht **13 1202**

LLNP faqet e internetit www.centrelink.gov.au/internet/internet.nsf/services/literacy_numeracy.htm

I dyti është **Workplace English Language and Literacy (WELL)** program (programi Gjuhës dhe Leximit Anglisht në Vendin e Punës) që ju siguron fonde organizatave për të trainuar punëtorët në aftësitë e gjuhës Angleze, leximit dhe numrave.

WELL Program **1300 363 079**

Website (Faqja e Internetit) www.deewr.gov.au

DEEWR siguron gjithashtu edhe mësimin intensiv të gjuhës Angleze për studentat e porsaardhur që i përfshin ligji dhe janë nën moshën 18 vjeçare nën **Programin English as a Second Language for New Arrivals (ESL-NA) program** (programi i Anglishtes si Gjuhë e Dytë për të Porsaardhurit). Programi synon që të përmirësojë mundësitë e arsimimit dhe rezultatet e studentave të porsaardhur nga prejardhjet jo-Angleze duke zhvilluar kompetencën e tyre në gjuhën Angleze dhe duke bërë më të lehtë pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet arsimore të shumicës.

Kurset e Anglishtes ju ofrohen gjithashtu nëpërmjet institucioneve të tjera mësimore dhe qendrave të komunitetit. Shikoni Kapitullin 7, *Employment* (Punësimi) dhe Kapitullin 10, *Education and child care* (Edukimi dhe Kujdesja për fëmijë) nën *Vocational education* (Mësimi për Zanatë).

Shërbimet e përkthimeve me gojë dhe me shkrim

Interpreting (Përkthimet me gojë)

Translating and Interpreting Service (TIS National) mund të sigurojë një përkthyes në telefon në më shumë se 120 gjuhë dhe dialekte. Ju mund t'i telefononi TIS National për koston e një thirrje lokale (kostoja e thirrjeve nga celularët mund të ndryshojnë). TIS National është i vlefshëm 24 orë në ditë, 7 ditët e javës dhe mund të ndihmojë në situatat e urgjencës prej cilitdo vend në Australi.

Nëse nuk flisni ose nuk kuptoni Anglisht dhe keni nevojë të flisni me një agjensi të qeverisë kërkoni atyre të kontaktojnë TIS National që t'ju ndihmojë të komunikoni me agjensinë. Normalisht do t'ju sigurohet një përkthyes në telefon por nëse është e nevojshme, agjensitë qeveritare mund të marrin një përkthyes që të jetë i pranishëm në takim. Agjensia qeveritare duhet të paguajë për koston e përkthyesit. Para se të telefononi bëni të sigurtë që ju kontrolloni orarin e punës të agjensisë qeveritare me të cilën dëshironi të flisni.

Nëse keni probleme për të kuptuar sistemin e automatizuar telefonik të agjencive qeveritare, telefononi direkt TIS National dhe ato do t'ju ndihmojnë.

(TIS National Kombëtar)

131 450

(Shërbimet e Përkthimeve me Gojë dhe me Shkrim)

TIS National website

www.immi.gov.au/tis

TIS National i mirëpret kërkesat e nënshtetasve dhe banorëve të përhershëm Australianë që shprehin interes të bëhen përkthyesa kontraktorë, për të siguruar shërbime përkthimi mbi baza kontaktimi anëtarëve të komunitetit Australian që flasin gjuhë jo Angleze. Nëse keni aftësi në gjuhën Angleze dhe të paktën në një gjuhë tjetër, ju mund të konsideroni aplikimin për tu bërë përkthyes me kontratë për TIS National. Për më shumë të dhëna në lidhje me punësimin e përkthyesave dhe kushtet e punës mund të kontaktoni Managjerin e Kontratave të TIS National në 1300 132 621.

Në se dëshironi të lidheni me Centrelink-un dhe keni nevojë për ndihmën e një përkthyesie, mund ta telefononi Centrelink-un direkt me numrin telefonik:

Centrelink (me ndihmën e një përkthyesie)

13 1202

Centrelink website

www.centrelink.gov.au

'I need an interpreter' card (Kam nevojë për një kartë përkthyesi)

TIS National bën një kartë 'I need an interpreter' për përdorim nga personat që nuk flasin Anglisht dhe që kërkojnë ndihmë me përkthim. Karta në masën e portofolit, me Simbolin e National Interpreter (Përkthyes Kombëtar) është projektuar për të ndihmuar personat që nuk flasin Anglisht për të kërkuar një përkthyes kur kanë nevojë të komunikojnë me agjencitë qeveritare, grupet e komunitetit dhe bizneset. Personat që nuk flasin Anglisht thjeshtë mund të paraqesin kartën për të treguar që ato kanë nevojë për një përkthyes.

Një shirit në ballë të kartës lejon që të shkruhet gjuha e preferuar e personit që nuk flet Anglisht, dhe në pjesën prapme ka të dhënat e kontaktimit të TIS National. Karta mund të përdoret nga çdo person në Australi që flet gjuhë që nuk është Anglisht dhe që ka nevojë ose dëshiron për të përdorur një përkthyes për të komunikuar.

TIS National i jep kartat falas një numri agjensish qeveritare, grupeve të komunitetit dhe agjensive jo-për- përfitim për t'ju shpërndarë klientave të tyre që nuk flasin Anglisht. Kartat mund të porositen nëpërmjet e-mailit nga ekipi i TIS Client Liaison and Promotions në tispromo@immi.gov.au.

Shënim: Në përgjithësi TIS National vepron mbi bazat e shërbimit me pagesë dhe pagesat e përkthimit mund të aplikohen.

Përkthimi i dokumenteve tuaja të rëndësishme

Një përkthim i përmbledhur/ekstrakt në Anglisht i dokumenteve tuaja të cilat mund të jenë të nevojshme për vendosjen tuaj në Australi mund të jepet falas nga Department of Immigration and Citizenship (Departamenti i Emigracionit dhe Nënshetësisë) (DIAC). Këto dokumente mund të pëfshijnë çertifikatat e lindjes e të martesës, patentën e makinës, kualifikimet arsimore dhe referencat e punësimeve.

Nëse dëshironi ndonjë përkthim falas, ju duhet të jeni banor i përhershëm ose nënshetë Australian dhe ju duhet ta bëni kërkesën brenda 2 vjetësh që nga dita e ardhjes ose e dhënies së qëndrimit të përhershëm. Ju duhet t'i dorëzoni kërkesën tuaj për përkthim nëpërmjet një institucioni që ofron shërbimin e Adult Migrant English Program AMEP (shikoni më poshtë).

Përkthimi i dokumentave të tjerë mund të organizohet nëpërmjet përkthyesave të akredituar mbi bazat e pagesës për shërbimin e kryer. Për një listë të përkthyesave të akredituar në gjuhën tuaj, vizitoni faqen e internetit të **National Accreditation Authority for Translators and Interpreters (NAATI)** (Autoritetit Kombëtar të Akreditimit për Përkthyesat).

NAATI Hotline

1300 557 470

NAATI website

www.naati.com.au/

3. Shërbimet e Urgjencës

Në raste urgjencash, telefononi **000**, për:

- [Police](#) (Policinë)
- [Ambulance](#) (Ambulancën)
- [Fire Brigade](#) (Zjarrfiksat)

Telefonatat në **000** (Numrin tre zero) janë falas. Qëndroni gati që të jepni emrin tuaj, adresën, numrin e telefonit (nëse keni), si dhe llojin e shërbimit që kërkon.

Nëse nuk flisni Anglisht, i thoni punonjësit të shërbimit telefonik se çfarë ndihme ju duhet (thone vetëm "Police" për – Policinë, "Ambulance" për–Ambulancën" ose "Fire" për – Zjarrfikësen, dhe pastaj tregoni gjuhën që flisni p.sh. "Albanian" dhe do të lidheni me Shërbimin e Përkthimit Telefonik (TIS National) direkt, prandaj mos e mbyllni telefonin. Përkthyesi i Shërbimit të Përkthimeve Telefonik (TIS National) do të ndihmojë policinë, zjarrfikësat apo shërbimin e ambulancës duke u treguar atyre adresën tuaj si dhe të dhëna të tjera rreth jush.

Policia

Në rast **urgjence**, telefononi **000** dhe kërkon "Police" (Policinë).

Për çështje **jo urgjente**, telefononi **131 444** ose stacionin e policisë lokale. Numrat e tyre ndodhen nën seksionin 'Police stations' në numërorin telefonik [White Pages](#). Shërbimet policore janë falas.

Policia në Australi nuk ka lidhje me ushtrinë dhe nuk ka rol në politikë. Ata kanë për qëllim të mbrojnë jetën dhe pronën e komunitetit dhe të parandalojnë dhe gjejnë krimin, si dhe të mbajnë paqen. Policia mund të ndërhyjë në çështjet familjare kur ka një grindje domestike ose shqetësim rreth abuzimit fizik, seksual ose psikologjik.

Ambulanca

Nëse keni nevojë për ambulancë, telefononi në **000** dhe kërkon "Ambulance" (Ambulancën). Ambulancat japin transport urgjent në spital si dhe kujdes të menjëhershëm mjekësor. Mos harroni, nëse nuk flisni Anglisht **MOS E MBYLLNI TELEFONIN**, thoni emrin e gjuhës suaj dhe një përkthyes do t'ju ndihmojë me telefonatën tuaj.

Në disa shtete dhe territore, shërbimi i ambulancës mund të jetë falas ose më i lirë vetëm për njerëzit që mund të marrin një pension nga Qeveria Australiane ose që kanë Health Care Card (Kartelë Shëndetësore) (të dhënë nga Centrelink-u për njerëzit që vlerësohen si me të ardhura të ulëta). Shërbimi mund të jetë i shtrenjtë nëse nuk merrni sigurime sociale, prandaj ju mund të dëshironi të bëheni anëtar i ambulancës ose të regjistroheni në një Fond Sigurimi Shëndetësor Privat që i mbulon këto shpenzime për ju. Shihni Kapitullin 11, The health system (Sistemi Shëndetësor).

Për informacion mbi Shërbimin e Ambulancës të NSW shikoni faqen e internetit që ju është dhënë. Për çështjet lokale ose se si të regjistroni një kompliment ose një ankesë me to, thërrisni numrin më poshtë:

[Ambulance Service of NSW](#)

(02) 9320 7777

Brigada e Zjarrfikësave

Në rast urgjent telefononi në **000** dhe kërkoni “**Fire Brigade**” (**Zjarrfikësat**) . Zjarrfikësat shuajnë zjarret, shpëtojnë njerëzit nga ndërtesat që digjen dhe ndihmojnë në situata kur rreziku vjen prej gazit apo kimikatet. Në raste jurgjente, ju mund të përdorni numrin e telefonit shënuar nën ‘Fire brigades’ në numeratorin telefonik White Pages.

Numra të tjerë të urgjencave

Numrat e telefonit të nevojshëm të urgjencave janë të rreshtuar në faqet e para të numeratorit lokal telefonik White Pages. Ato përfshijnë:

Poisons Information Centre (Qendra e informimit për Helmime) **13 1126**
(Linja 24 Orëshe)

[Child Abuse Prevention Services \(CAPS\)](#) **1800 688 009**
(Shërbimet e Parandalimit të Abuzimit të Fëmijëve)
(Linja 24 Orëshe në rast krize)

4. Ku të shkoni për ndihmë

Shërbimet e vendosjes për emigrantët e porsa-ardhur

The Department of Immigration and Citizenship (DIAC) financon **Settlement Grants Program (SGP)** (Programin e Dhuratave monetare për Vendosje që siguron shërbime të ngulimit për banorët e përhershëm e porsa ardhur të hyrë për arsye humanitare, emigrantët që kanë bërë bashkim familjar dhe që kanë nivel të ulët të Anglishtes.

Personat në ngarkim të emigrantëve me mjeshtëri duke përfshirë ato që mbajnë viza të përkohëshme si dhe ato që mbajnë Provisional Spouse dhe Interdependency (viza për Martesë të Ardhsme) dhe personat në ngarkim të tyre në zonat fshatare dhe rajonale që kanë nivel të ulët të Anglishtes mund të kenë të drejtë për këto shërbime.

Nën **SGP**, organizatat financohen që të sigurojnë projekte për të ndihmuar të porsaardhurit të bëhen të pavarur dhe të marrin pjesë barazisht në shoqërinë Australiane sa më shpejt që të jetë e mundur pas mbërritjes. Projektet mund të jenë në fushat e Orientimit me Australinë, Zhvillimin e Komuniteteve dhe Integrimin.

Informacioni mbi SGP, duke përfshirë të dhënat e organizatave të financuara nga SGP, mund të gjendet në

Settlement Grants Program (SGP)

www.immi.gov.au/living-in-australia/delivering-assistancesettlement-grants/

Settlement Services Locator

www.immi.gov.au/living-in-australia/settle-in-australia/find-help/where-to-help/index.htm

Qendrat Përkrahëse për Emigrantë dhe Agjensitë e Shërbimit për Emigrantë

Migrant Resource Centres (MRCs) dhe **Migrant Service Agencies (MSAs)** kanë nëpunës që ju japin ndihmë dhe informacion kur arrini në Australi, veçanërisht nëse vini nga një vend ku nuk flitet gjuha Angleze. Ata mund t'ju drejtojnë në shërbime të tjera të dobishme. Shikoni listen e mëposhtme për vendndodhjen e MRC-së apo MSA-në më të afërt dhe duhet të jetë një nga pikat e para të takimit pas mbërritjes në Australi. Kontaktoni:

**Baulkham Hills/Holroyd/
Parramatta MRC**
15 Hunter St
PARRAMATTA NSW 2150
Tel: **(02) 9687 9901**
Fax: (02) 9687 9990
Web: www.bhhpmrc.org.au

Auburn MRC
17 Macquarie Rd
AUBURN NSW 2144
Tel: **(02) 9649 6955**
Fax: (02) 9649 4688
Web: www.amrc.org.au

Canterbury Bankstown MRC
2nd Floor, 59-63 Evaline St
CAMPSIE NSW 2194
Tel: **(02) 9789 3744**
Fax: (02) 9718 0236
Web: www.cbmrc.org.au

Blacktown MRC
Level 2, 125 Main St
BLACKTOWN NSW 2148
Tel: **(02) 9621 6633**
Fax: (02) 9831 5625
Web: www.blacktownmrc.org.au

Illawarra Multicultural Services Inc.

Wollongong Office
27 Atchison St
WOLLONGONG NSW 2500
Tel: **(02) 4229 6855**
Fax: (02) 4226 3634
Web: www.ims.org.au

Nowra Office

East Nowra Neighbourhood Centre
Cottage 2, 80 Park Road
East Nowra NSW 2541

Macarthur Diversity Services

Level 2, Centre Court, 101 Queen St
CAMPBELLTOWN NSW 2560
Tel: **(02) 4627 1188**
Fax: (02) 4628 6068
Web: www.mdsi.org.au

Liverpool MRC

Ground Floor, 108 Moore Street
LIVERPOOL NSW 2170
Tel: **(02) 9601 3788**
Fax: (02) 9601 1398
Web: www.lmrc.org.au

Northern Settlement Services

8 Chaucer St
HAMILTON NSW 2303
Tel: **(02) 4969 3399** or
1800 813 205
Fax: (02) 4961 4997
Web: www.mrcnh.org

MigrantLink

Level 3, 20 George St
HORNSBY NSW 1630
Tel: **(02) 9987 2077**
Fax: (02) 9987 1619
Web: migrantlink.org/index.htm

Wodonga:

Skilled Migration Coordinator
City of Wodonga
104 Hovell St
WODONGA VIC 3690
Tel: **(02) 6022 9267**
Email: skilled@wodonga.vic.gov.au

Settlement Assistance
Coordinator
City of Wodonga
104 Hovell St
WODONGA VIC 3690
Tel: **(02) 6022 9339**
Email: info@wodonga.vic.gov.au

Queanbeyan:

The Migrant Resource Centre of Canberra and Queanbeyan Inc.

2nd Floor, North Building
180 London Circuit
CIVIC ACT 2601
Tel: **(02) 6248 8577**
Fax: (02) 6257 7655
Email: mrc@mrccanberra.org.au

Queanbeyan Multilingual Centre (MRC)

12 Rutledge St
QUEANBEYAN NSW 2620
Tel: **(02) 6297 6110**
Fax: (02) 6297 0386
Email: anu.gmlc@bigpond.com

Griffith:

Griffith Multicultural Community
Council Inc. Resource and Information
Centre
81 Kooyoo St
GRIFFITH NSW 2680

Griffith Multicultural and Migrant
Settlement Services
Griffith City Council
81 Kooyoo St
GRIFFITH NSW 2680

Tel: (02) 6964 2023
Email: gmcci@bigpond.net.au

Tel: (02) 6962 9985
Fax: (02) 6962 9956
Email: settlement@griffith.nsw.gov.au

Adult Migrant English Program (AMEP) (Programi i Anglishtes për Emigrantët e Moshës së Rritur)

Mësuesit e 'AMEP' jo vetëm që mund t'ju ndihmojnë me gjuhën Angleze por ata edhe mund t'ju ndihmojnë të kuptoni mënyrat e jetesës Australiane si dhe aktivitetet e përditshme si shërbimet bankare, pazaret, aplikimet për punë dhe pjesëmarrjen në komunitet. Njerëzit në klasën tuaj mund të ndodhen në rrethana të ngjashme me ju dhe mund të kenë të dhëna të dobishme për ju. Për më shumë informacion për AMEP, shihni Kapitullin 2, Help with English (Ndihmë me Anglishten).

Settlement Services Locator

www.immi.gov.au/living-in-australia/settle-in-australia/find-help/where-to-help/index.htm

Organizatat etnike dhe të komunitetit

Ka shumë organizata etnike dhe të komunitetit që mund t'ju ndihmojnë ose të ju rekomandojnë tek ato që mund t'ju ndihmojnë juve. Ka gjithashtu klube, shoqata dhe organizata fetare, anëtar i të cilave mund të dëshironi të bëheni. Ato janë shënuar nën 'Clubs' dhe 'Organisations' në numërorin telefonik të quajtur [Yellow Pages](#) (Faqet e Verdha). Qendra juaj Përkrahëse për Emigrantë ose Agjensia e Shërbimit për Emigrantë janë të gatshëm t'ju japin listën e klubeve dhe organizatave që mund t'ju përshtaten nevojave dhe interesave tuaja.

Ndihma fillestare e vendosjes për personat e hyrë për arsye humanitare

Integrated Humanitarian Settlement Strategy (IHSS) (Strategjia e Integruar e Vendosjes së Personave të Hyrë për Arsye Humanitare) e departamentit ofron fillimisht ndihmë intensive për vendosjen e personave të porsaardhur të hyrë për arsye humanitare, në përgjithësi rreth 6 muaj, por kjo mund të zgjatet për klientat që përballohen me vështirësi të mëtejshme.

IHSS synon të ndihmojë personat e hyrë për arsye humanitare të bëhen të zotët e vetes sa më shpejt që të jetë e mundur duke ju ofruar ndihmë të specializuar sipas nevojës. Nëpërmjet mënyrës së ndjekjes së çështjes, identifikohen nevojat e personave të hyrë për arsye humanitare dhe një plan i çështjes zhvillohet për dhënien e ndihmës.

Informacion i mëtejshëm mbi IHSS, duke përfshirë të dhënat e organizatave të financuara nga IHSS mund të gjenden

Integrated Humanitarian Settlement Strategy (IHSS)

www.immi.gov.au/living-in-australia/settle-in-australia/find-help/ihss

Shërbimet për të rinjtë

Punonjësit për të rinjtë janë njerëz të kualifikuar dhe me përvojë, të cilët punojnë me të rinjtë. Ata punojnë në Qendra Rinore, Qendra Përkrahëse Emigrantësh dhe këshillat lokale dhe pajisin të rinjtë me informacion, ndihmë dhe veprimtari në mjedis të shëndoshë.

Faqja e internetit e **The Source** është faqja e Qeverisë së Commonwealth-it për rininë që ofron një sërë informacionesh për të rinjtë.

| | |
|---|--|
| Kids Helpline (Linja është e hapur 24 orë) | 1800 551 800 |
| Kids Help website | www.kidshelp.com.au |
| The Source | www.thesource.gov.au |

Për më shumë informacion rreth punonjësve për rininë kontaktoni:

| | |
|---|--|
| Youth Action and Policy Association NSW (YAPA) (Australia wide) | (02) 9319 1100 |
| Në NSW Falas për telefonat e shtëpisë | 1800 627 323 |
| E-mail | info@yapa.org.au |
| Website | www.yapa.org.au |

Ndihma Ligjore

Në çdo shtet dhe territor ndodhen organizata të komunitetit që punojnë për të informuar njerëzit lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore, dhe për t'i përmirësuar (me anë të informimit) mundësitë e tyre për t'u lidhur më mirë me sistemin e drejtësisë.

| | |
|---------------------------------|--|
| LawAccess NSW | 1300 888 529 |
| TTY (për shurdh/memecat) | 1300 889 529 |
| LawAccess NSW website | www.lawaccess.nsw.gov.au |

Për ndihmë në çështjet ligjore lidhur me sigurimin social:

| | |
|---|--|
| Illawarra Legal Centre 7 Greene St WARRAWONG NSW 2502 Tel: (02) 4276 1939 Fax: (02) 4276 1978 TTY: 13 36 77 Website: www.illawarralegalcentre.org.au | Welfare Rights Centre 102, 55 Holt Street SURRY HILLS NSW 2010 Tel: (02) 9211 5300 (Sydney) Tel: 1800 226 028 (outside Sydney metropolitan) TTY: (02) 9211 0238 Fax: (02) 9211 5268 Email: welfarerights@welfarerights.org.au Website: www.welfarerights.org.au |
|---|--|

Për ndihmë lidhur me çështjet e imigrimit:

Immigration Advice and Rights

Centre

Level 5, 362 Kent St

SYDNEY NSW 2000

Tel (admin): (02) 9279 4300

Telephone Advice Line:

(02) 9262 3833

Hours: Tuesday & Thursday 2-4pm

Fax: (02) 9299 8467

Email: iarc@iarc.asn.au

Website: www.iarc.asn.au

Dhuna

Ekzistojnë shërbime të ndryshme për të ndihmuar viktimat e krimeve apo të dhunës, duke përfshirë edhe dhunën në familje. Njerëz të tjerë ndihmojnë gratë dhe burrat, si dhe familjet e tyre për t'i përballuar streset që shpesh herë kontribuojnë në shpërthimin e dhunës në familje. Ju lutem shikoni Kapitullin 5, *Zakonet dhe Ligjet Australiane*.

Child Abuse Prevention Services (CAPS) 1800 688 009

(Linja 24 Orëshe Falas në rast Krize)

CAPS website www.childabuseprevention.com.au

Violence Against Women (Linjë Ndihme 24 Orëshe) 1800 200 526

Violence Against Women website www.australiasaysno.gov.au

(duke përfshirë informacion në gjuhët jo Anglisht)

Domestic Violence Advocacy Service (Sydney Advice Line) (02) 8745 6999

Rural Free Call Line 1800 810 784

TTY (for hearing and speech impaired) 1800 626 267

Immigrant Women's Speakout (02) 9635 8022

NSW Department of Community Services 24-Hour Domestic Violence Line 1800 656 463

Të Drejtat e Konsumatorit

Zyrat e **Ombudsman-it** hetojnë ankesat për organizatat qeveritare, kompanitë private në disa industri. Ato mund të marrin masa që t'u japin fund praktikave të trajtimeve të paligjshëm, të padrejta ose diskriminuese ndaj jush, ose të ndërhyjnë në përpjekje për një rezultat më të drejtë për ju (kur nuk jeni dakort me ndonjë vendim)

Australian Communications dhe Media Authority (ACMA) (Autoriteti Australian i Transmetimeve dhe Medias), bën hetime të ankesave të njerëzve rreth përmbajtjes së papërshtatshme të shërbimeve të transmetimit të radios, televizionit dhe të internetit. Fillimisht ankesat duhet t'i drejtohen pronarit të shërbimit. Në se nuk zgjidhjet çështja e ankesës keni të drejtë ta dërgoni ankesën tuaj organit ACMA. Për më shumë informacion kontaktoni:

Australian Communications and Media Authority (Thirrje falas) 1800 226 667
TTY (për shurdh/memecat) (03) 9963 6948
ACMA website www.acma.gov.au

Australian Competition and Consumer Commission (ACCC) (Komisioni Australian i Konkurrencës dhe Konsumatorit) u jep konsumatorëve një mbrojtje ndaj praktikave biznesore të padrejta në fushat e vendosjes së çmimeve dhe praktikave tregtare të padrejta. Ky Komision mbron konsumatorët edhe ndaj praktikave që janë kundra konkurimit. Së fundi, i mbron konsumatorët edhe në lidhje me sigurinë e prodhimeve.

Disa numra kontakti janë:

| | |
|--|----------------|
| <u>Australian Competition & Consumer Commission</u> | 1300 302 502 |
| <u>Commonwealth Ombudsman</u> (Ombudsmani i Commonwealth-it) | 1300 362 072 |
| <u>Advertising Standards Bureau</u> (Byroja e Standarteve të Reklamimit) | (02) 6262 9822 |
| <u>Banking and Financial Services Ombudsman</u> | 1300 780 808 |
| <u>Credit Union Dispute Resolution Centre</u> | 1300 780 808 |
| <u>Financial Industry Complaints Service</u> (Shërbimi i Ankesave për Industrinë e Financave) | 1300 780 808 |
| <u>Insurance Ombudsman Service</u> | 1300 780 808 |
| <u>Financial Co-operative Dispute Resolution Scheme</u> | 1300 780 808 |
| <u>Private Health Insurance Ombudsman</u> (Ombudsmani i Sigurimit Shëndetësor Privat) | 1800 640 695 |
| <u>Superannuation Complaints Tribunal (SCT)</u> | 1300 780 808 |
| <u>Telecommunications Industry Ombudsman</u> (Ombudsmani i Industrisë së Telekomunikacionit) | 1800 062 058 |
| <u>NSW Ombudsman</u> (general enquiries) | (02) 9286 1000 |
| Or if you are calling from outside Sydney | 1800 451 524 |
| TTY (for speech and hearing impaired) | (02) 9264 8050 |
| <u>Office of Fair Trading</u> | 13 3220 |
| TTY (for speech and hearing impaired) | 1300 723 404 |
| <u>Energy and Water Ombudsman (NSW EWON)</u> | 1800 246 545 |

Këshillat Lokale

Ju mund të kontaktoni bashkinë tuaj të qytetit ose zyrat e këshillit për informacion mbi shërbimet në zonën tuaj lokale. Ato janë të regjistruar nën 'Local Councils' në numërorin telefonik [White Pages](#) (Faqet e Bardha). (Shikoni Kapitullin 14, *Local Government* (Qeveria Lokale)).

The Australian Government Regional Information Service (AGRIS)

Australian Government Regional Information Service (Shërbimi Informativ i Qeverisë Australiane për Krahinat) është një shërbim informativ për shërbimet Qeveritare të Commonwealth-it dhe programet për Australinë rurale dhe rajonale. Ky shërbim informativ nxjerrë në shtyp *The Australian Government Regional Information Directory (Udhëzuesi Informativ Rajonal i Qeverisë Australiane)*, të cilin mund ta merrni duke telefonuar:

Australian Government Regional Information Service **1800 026 222**

AGRIS Regional Entry Point website www.regionalaustralia.gov.au

Lehtësim në rast Urgjence

Nëse keni nevojë urgjente për ushqime, veshje, strehim apo orendi ju mund të kërkonti ndihmë nga non-government organisations (NGO) (organizatat joqeveritare) si :

St Vincent de Paul Society **(02) 9560 8666**
(enquiries)

St Vincent de Paul website www.vinnies.org.au

The Salvation Army (për dhurata
financiare, Dyqanet e Salvos,
Punësimi Plus, dh ekërkesa të
përgjithëshme) **13 72 58**

Salvo Care Line **1300 363 622**

Salvation Army website www.salvos.org.au

The Smith Family (Skema e Mësimi
në Shtëpi dhe Secili Mëson Dikë) **(02) 9744 3188**

Smith Family website www.thesmithfamily.com.au

Mos keni frikë të kërkonti ndihmë. Mund të ketë kushte të veçanta që caktojnë nëse ju takon me ligj ndihma nga këto organizata, nga ana tjetër gjenden një numër i madh organizatash që mund të asistojnë njerëz në rrethana të ndryshme. Ju mund të kontaktoni MRC-në ose këshillin lokal të shikoni se çfarë gjendet në zonën tuaj.

Gjetja e të afërmve

Australian Red Cross (Kryqi i Kuq Australian) ofron shërbime për gjetjen dhe dërgimin e mesazheve për të afërm të ndarë nga lufta, nga përplasjet civile dhe fatkeqësitë natyrore.

Australian Red Cross (NSW Office
International Tracing Service) **(02) 9229 4143**

Red Cross website www.redcross.org.au

Telefoni për këshillim në kriza

Gjenden shumë shërbime telefonike këshillimi duke përfshirë **Lifeline** që ju ofron këshillim falas në raste krizash gjatë 24 orëve të 7 ditëve të javës. Ju mund të ndiheni të dëshpëruar, thjesht të keni nevojë të flisni me dikë ose të dëshironi të përdorni shërbimet e këshillimit të veçantë për financa, kumar, apo për të rinj.

Lifeline (Linja 24 Orëshe në rast Krize) **13 1114**

Lifeline website www.lifeline.org.au

Martesa dhe marrëdhënjet e tjera të afërta.

Relationships Australia (Shërbimi, Marrëdhëniet Australia) ofron këshillime me psikolog, edukim dhe shërbime ndërmjetësimi për individë, çifte dhe familje. Kostoja e tyre varet nga niveli i të ardhurave tuaja. Në se është e nevojshme mund të sigurojnë edhe përkthyes për ju.

Relationships Australia

1300 364 277

Relationships Australia website

www.relationships.com.au

Men's Line Australia (Linja telefonike për Burrat Australianë) ofron këshillime me psikologë, informacion dhe shërbime referimi për të ndihmuar meshkujt në lidhje me problemet e jetës së tyre familjare apo në marrëdhënjet tyre të ngushta. Kjo linjë telefonike ofron përkrahje dhe ndihmë edhe për gratë dhe anëtarët e tjerë të familjes që shqetësohen për rreth partnerit, burrit, apo babait të tyre. Për më shumë informacion kontaktoni:

Men's Line Australia (Linja është e hapur 24 orë)

1300 789 978

Men's Line Australia website

www.menslineaus.org.au

Këshillime për njerëz që janë torturuar dhe traumatizuar

Service for the Treatment and Rehabilitation of Torture and Trauma Survivors (STARTTS) (Shërbimi për Mjekimin dhe Rihabilitimin e Personave që kanë Përjetuar Tortura dhe Trauma) në NSW (New South Wales) është një shërbim në mbarë shtetin që ofron këshillime dhe përkrahje për refugjatët dhe për personat me rrethana të ngjashme me ato të refugjatëve.

Shërbimet e STARTTS përfshijnë vlerësim të anës psikologjike, këshillim, fizioterapi, ndihmë psiqiatrike, pjesëmarrjen tuaj në grupe për edukimin dhe shërimin tuaj, kampe për të rinjtë, si dhe program enkas për t'i ndihmuar familjet në stabilizimin dhe ambientimin e tyre në Australi. Përveç kësaj, STARTTS është i financuar veçanërisht për të siguruar ndihmë dhe këshillim për refugjatët e porsaardhur brenda 12 muajve të tyre të parë të vendosjes në zonën e qytetit të Sidneit, Newcastle dhe Wollongong

STARTTS ka në dispozicionin tuaj psikologë të specializuar, nëpunësa projektesh të cilët flasin disa gjuhë të ndryshme dhe përkthyesat mund të thirren nëse është e nevojshme për të marrë pjesë në sesionet e këshillimit. Shërbimet e STARTTS nuk kanë nuanca fetare dhe janë a-politike dhe konfidenciale. Informacione të tjera sigurohen nga faqja e internetit ose duke telefonuar:

Carramar (Rekomandimet/kërkesat për shërbimet/pyetjet në lidhje me zonat e largëta)

(02) 9794 1900

(zyra e degës) Auburn

(02) 9646 6666

(zyra e degës) Liverpool

(02) 8778 2000

(zyra e degës) Coffs Harbour

(02) 6650 9195

(zyra e degës) Newcastle

(02) 4924 6286

STARTTS website

www.startts.org.au

Shërbimet Financiare

Në Australi gjenden një numër i madh bankash, lloje të sigurimeve shëndetsore dhe materiale, superannuation (pagesa të bëra nga punëdhënësi për kohën e pensionimit) si dhe prodhime dhe shërbime të ndryshme të investimeve. Prodhimet dhe shërbimet financiare

mund të kryhen vetëm nga një biznes që ka licensën nga Qeveria për t'i kryer këto veprime. Është e kundraligjshme oferta e kryerjes së shërbimeve financiare pa patur licensën e duhur.

Understanding Money Website www.understandingmoney.gov.au/content/

Gjenden njerëz të pandërgjegjshëm që mund të përpiqen t'ju vjedhin duke ju mashtruar që ju t'ja jepni paratë tuaja. Nëqoftëse keni ndonjë ankesë rreth depozitimit të parave, kredive biznesore, sigurimeve materiale, superannuation, këshillave rreth investimeve apo financave në përgjithësi, apo nuk jeni të sigurtë ose keni dyshime rreth ndonjë telefonate në lidhje me ndonjë investim, kontaktoni **Australian Securities and Investments Commission (ASIC)**, (Komisioni i Sigurimeve dhe Investimeve të Australisë).

ASIC Infoline (Numri i telefonit për Informacione)

1300 300 630

ASIC website

www.fido.asic.gov.au

Veprimet bankare

Shërbimet bankare ofrohen nga vet bankat, shoqëritë ndërtimore si dhe njësive të dhënjes së kredive. Për të tërhequr paratë mund të shkoni direkt në bankë ose mund t'i tërhiqni me kartën bankare duke futur numrin **PIN** (Personal Identification Number) (Numri Identifikues Personal), (d.m.th. kodin tuaj sekret) për të nxjerrë kartmonedhat nga **ATM** (Automatic Teller Machine) (Makina Automatike e Nxjerrjes së Parave nga Banka). Mos e shënوني numrin tuaj PIN në kartën tuaj bankare! Nëqoftëse ndodh që karta e juaj bankare vidhet ose e humbisni – menjëherë lajmëroni bankën tuaj.

Huatë dhe Kreditë

Me '[Kreditë e Ndryshme](#)' kuptohet rasti kur ju merrni para borxh dhe bini dakort që do t'i paguani më vonë me fajde, që quhet 'interest'. Disa nga kreditë e ndryshme janë kredi personale, kredi për shtëpi, kartat e kreditit si dhe 'overdrafts' (kreditë nga banka që i lejojnë bizneset të lëshojnë çeqe me shuma më të mëdha se ç'disponojnë vet në llogarinë e tyre). Kostoja e kreditit varet shumë nga lloji i kredisë, nga merret kredia, sa kohë ju duhet për ta paguar, përqindja e interesit si dhe pagesa të tjera të lidhura me kredinë. **Është e rëndësishme që ju të mos merrni një borxh ose të mos përdorni një kartë krediti nëse nuk keni mundësi t'i ripaguani.**

Nëqoftëse hasni vështirësi në pagimin e kredisë për shkak se humbisni punën apo sëmureni, keni të drejtë të kërkoni që të bëhen ndryshime në pagimin e kredisë. Nëse ju duhet ndihmë kontaktoni:

[Shërbimi Informativ Financiar i Centrelinkut](#)

13 2300

[Këshilltarët financiarë](#) ofrojnë këshilla falas në kushte të konfidencës. Për ta gjetur një këshilltar financiar afër jush kontaktoni Australian Securities and Investments Commission (ASIC) (Komisioni Australian i Obligacioneve dhe Investimeve) ose Shërbimi Financiar Informativ i Centrelink:

Sigurimi material

[Sigurimi material](#) (insurance) përfshin pagimin e një shume parash çdo vit për t'u mbrojtur nga rreziku i humbjes së parave nëse nuk shkojnë punët në rregull ose ndodh diçka. Të zakonshme janë sigurimet materiale për shtëpinë, për mobiljet dhe paisjet e tjera si dhe për makinën. Nëqoftëse keni makinë, ju nevojitet sigurimi material për t'i mbuluar shpenzimet nëse ju dëmtoni personin tjetër në rastin e një aksidenti. You mund të dëshironi të bëni siguracion të plotë makine që ju siguron mbulim më të gjërë.

Tax Help (Ndhinë për Taksën)

Viti Australian i taksës (ose 'financial year' (viti financiar)) është nga 1 Korriku deri me 30 Qershor. Sipas ligjit Australian shumicës së njerëzve u kërkohet të fusin taksën e kthimeve në Australian Tax Office çdo vit ndërmjet 30 Qershorit dhe 31 Tetorit.

Tax Help ju ofrohet njerëzve me të ardhura të ulëta, duke përfshirë moshat e vjetra, atyre që vijnë nga vende që nuk flasin Anglisht, atyre me prejardhje Aborigene apo prej ishullit Torres Strait ose të paafteve. Tax Help (Ndhinë për Taksën) është shërbim falas dhe është i disponueshëm prej 1 Korrikut deri më 31 Tetor. Për të gjetur nëse jeni të ligjshëm dhe vendodhjen e **Tax Help Centre** (Qendrës së Ndhinës për Taksë) tuaj më të afërt telefononi:

Tax Help

13 2861

5. Ligji dhe zakonet Australiane

Njohja dhe kuptimi i zakoneve dhe ligjeve Australiane ju ndihmon t'i përshtateni jetës në komunitetin Australian.

Australia është një shoqëri tolerante, e larmishme me njerëz nga prejardhje kulturore dhe etnike të ndryshme. Australianët vijnë nga të gjitha qoshet e botës. Rreth 45 për qind e Australianëve kanë lindur jashtë shtetit ose kanë një prind që ka lindur jashtë shtetit. Megjithëse Anglishtja është gjuha kombëtare, në Australi fliten rreth 300 gjuhë duke përfshirë gjuhët e vendasve. Australianët praktikojnë gjithashtu dhe një larmi të madhe besimesh fetare.

Në Australi, gjithësecili brenda ligjit është i lirë të shprehë dhe të mbajë kulturën e tyre dhe traditat fetare, dhe të pjesmarrë e të përkasë si një Australian. Në fillim, ju mund të mos jeni mësuar me një larmi të tillë. Mirëpo nëse ju jeni të hapur dhe tregoni respekt ndaj njerëzve të tjerë, ideve dhe traditave, është krejt e mundur që të përshtateni dhe të jeni të sukseshëm në jetën tuaj të re.

Përgjegjësitë dhe vlerat

Liria dhe barazia që ne gëzojmë në Australi varen nga fakti që të gjithë të përmbushin përgjegjësitë e tyre. Ne presim nga ju që të jeni besnikë ndaj Australisë, që të mbështesni mënyrën tonë demokratike të jetesës dhe ndihmoni të mbani traditën Australiane të pranimi, përfshirjes dhe ndershmërisë për të gjithë.

Vlerat tona sigurojnë bazat për shoqërinë e lirë dhe demokratike Australiane. Ato përfshijnë:

- respektin për vlerat e barabarta, dinjitet dhe lirinë e individit
- lirinë e fjalës
- lirinë e besimit dhe qeverisë laike
- lirinë e shoqërimit
- mbështetjen e demokracisë parlamentare dhe rregullave të ligjit
- barazinë nën ligjin
- barazinë e burrave dhe grave
- barazinë e mundësive
- paqe
- Shpirtin egalitarian që përqafton tolerancën, respektin e dyanshëm dhe dhembshurinë për ato që kanë nevojë.

Barazia dhe qëndrimi kundra diskriminimit

Ju keni të drejtën të respektoheni dhe nevojat tuaja të konsiderohen njësoj si të tjerëve. Në mënyrë të ngjashme, ju duhet të respektoni të tjerët, pavarësisht nëse kanë lindur në Australi ose, si ju, kanë emigruar këtu.

Sipas ligjeve të anti-diskriminimit të federatës dhe shtetit/territorit askush nuk duhet të trajtohet në mënyrë të pafavorshme nga të tjerët për shkak të moshës, racës, përkatësisë kombëtare, vendlindjes, gjinisë, gjendjes civile, shtatzanisë, besimit politik ose fetar, paaftësisë trupore / mendore ose preferencës seksuale. Kjo vlen për shumicën e fushave, duke përfshirë punësimin, arsimin, strehimin, blerjen e të mirave materiale dhe shfrytëzimit të shërbimeve që ofrohen nga mjekët, bankat dhe hotelet. Burrat dhe gratë janë të barabartë para ligjit si dhe për të gjitha gjërat e tjera.

Australia ka traditën e fjalës së lirë. Mirëpo, është e kundraligjeshme ta ofendosh, ta shash, ta ulesh apo ta frikësosh një person apo një grup njerëzish për shkak të racës, gjinisë, gjendjes civile, shtatzansisë apo të besimeve fetare ose politike që mund të kenë.

Programi i Qeverisë Australiane i **Living in Harmony (Jetesës në Harmoni)** reklamon vlerat Australiane të përshkuara më sipër, detyrimin dhe mirëkuptimin e dyanshëm mes njerëzve nga prejardhje të ndryshme. Gjithashtu synon të adresojë dhe mostolerimin. Këtë e bën nëpërmjet:

- projekteve të komunitetit lokal
- partnerive me organizatat kombëtare
- strategjisë së informimit publik, që përfshin Ditën e Harmonisë me 21 Mars të çdo viti.

Për më shumë informacion, kontaktoni:

| | |
|---|--|
| Harmony Day | 1800 331 100 |
| Funded community projects | 1800 782 002 |
| Living in Harmony (Të jetuarit në Harmoni) | www.harmony.gov.au |

Australian Human Rights Commission – Komisioni Australian i të Drejtave të Njeriut merret me zbatimin e ligjit të Komonuellthit në fushën e të drejtave të njeriut, të antidiskriminimit dhe të drejtësisë.

| | |
|---|--|
| Australian Human Rights Commission | 1300 369 711 |
| TTY (për shurdh/memecat) | 1800 620 241 |
| Website (duke përfshirë informacion në gjuhët jo Anglisht) | www.hreoc.gov.au |
| <u>Anti Discrimination Board of New South Wales</u> | |
| Sydney (numri i përgjithshëm i zyrës) | (02) 9268 5555 |
| Sydney (general enquiry service and employer advisory service) (shërbimi i kërkaseve të përgjithëshme dhe shërbimi i këshillimit për punëdhënësit) | (02) 9268 5544 |
| TTY (për shurdh/memecat) | (02) 9268 5522 |
| Wollongong | (02) 4224 9961 |
| Newcastle | (02) 4926 4300 |
| Rural and Regional NSW (Tollfree) | 1800 670 812 |

Shkeljet e Kodit Penal- Krimet

Krimi zakonisht përcaktohet si një sjellje ose akt i kundraligjshëm dhe mund të rezultojë me dënime. Pritet nga gjithësecili në Australi bindje ndaj gjithë ligjeve Australiane në fuqi. Për më shumë informacion rreth shkeljeve kriminale dhe rolit të policisë në Australi, shikoni faqen e internetit: www.apmab.gov.au/pubs/PoliceGuide.html (e vlefshme në 8 gjuhë).

Në se keni qenë dëshmitar në ndonjë shkelje kriminale ose keni informacion që mund ta ndihmojë policinë në zgjidhjen e ndonjë krimi, kontaktoni:

| | |
|--|---------------------|
| <u>Crime Stoppers</u> (Ndaluesit e Krimeve) | 1800 333 000 |
|--|---------------------|

Ritet fetare si dhe zakonet kulturore duhet të pajtohen me ligjet ekzistuese Australiane. Për shembull, ligjet në shtet dhe territore ndalojnë ritet e disa vendeve që zbatojnë dhunën në familje si dhe genital mutilation.

Dhuna ne familje

Si dhe në vendet e tjera dhuna karshi një personi tjetër është e kundraligjshme. Kjo shkelje merret shumë seriozisht. Me “dhunën në familje” përshihet dhuna brenda shtëpisë dhe brenda çiftit të martuar. Kjo është mënyra e sjelljes së një personi që do të thotë se viktimi pëson ose ka frikë që mund të pësojë abuzim fizik, seksual ose psikologjik dhe dëmtim, marrëdhënie seksuale me forcë, izolim të detyruar ose mangësi ekonomike (kur nuk ja lejon bashkëshorti etj të drejtën e mbajtjes apo të harxhimit të parave). Për informacione kontaktoni:

| | |
|---|--|
| Violence Against Women (Linjë Ndihme 24 Orëshe) | 1800 200 526 |
| Violence Against Women website (duke përfshirë informacion në gjuhët jo Anglisht) | www.australiasaysno.gov.au |
| Men's Line Australia (Linja është e hapur 24 orë) | 1300 789 978 |
| Men's Line Australia website | www.menslineaus.org.au |
| <u>Domestic Violence Advocacy Service</u> (Sydney Advice Line) (ose nëse thërrisni prej jashtë Sidneit) | (02) 8745 6999 1800 810 784 |
| TTY (për shurdh/memecat) | 1800 626 267 |
| NSW Department of Community Services 24-Hour Domestic Violence Line | 1800 656 463 |
| Kids Helpline (24 hour service) | 1800 551 800 |
| <u>Immigration Advice and Rights Centre</u> (Advice Line) | (02) 9262 3833 |
| <u>Immigrant Women's Speakout</u> | (02) 9635 8022 |

Në se frikë urgjente për sigurinë tuaj telefononi në linjën ‘**Police**’ **000** ose në stacionin lokal të policisë dhe kërkoni Nëpunësin e Komunikimit për Dhunën në Familje. Në se kërkohet ndihmë me përkthimin thërrisni TIS National në **131 450**.

Mosha ligjore e miratimit

Legal age of consent (që është, mosha që ligji njih të drejtën tuaj për të rënë dakord për kryer marrëdhënie seksuale me një person tjetër) ndryshon nga një shtet në tjetrin në Australi. Është ilegale të kryeni marrëdhënie seksuale me dikë që është më i/e vogël së mosha e njohur nga ligji dhe mund të ketë dënime shumë të rënda për cilindo që thyen këtë ligj.

Në New South Wales the age of consent është 16 vjeç si për burra ashtu edhe për gra. Ky Ligj mbron moshat e reja nga shfrytëzimi seksual.

Ju mund të gjeni më shumë informacion rreth moshës së pranimit duke kontaktuar klinikën e shëndetit seksual ose klinikën e planifikimit familjar.

Të drejtat e fëmijëve

Australia është i përkushtuar mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, që mund të jetë ndryshe në disa praktike kulturore në lidhje me rritjen e fëmijëve. Praktika të veçanta që janë ilegale nën ligjin Australian përfshijnë detyrimin e martesës në moshë të re dhe gjymtimin (prerjen) e organit gjenital të femrave. Është gjithashtu ilegale për të marrë ose për të dërguar një fëmijë në një vend tjetër për një martesë të detyruar në moshë të re ose për gjymtimin e organit gjenital femëror, ose për të gjetur dikë tjetër që e organizon një gjë të tillë. Ka shërbime të vleshme që ju përgjigjen këtyre praktikave.

Fëmijët mbrohen nga ligji prej abuzimit fizik, seksual dhe emocional, neglizhencës dhe dhunës, si në shtëpi dhe në shkollë, dhe përkujdesje e arsyeshme duhet tu kushtohet mbikqyrjes dhe kujdesit të tyre. Në përgjithësi diskurajohet disiplinimi fizik, dhe nëse shkakton dëme të rënda është ilegal. Ajo nuk lejohet në shkolla.

Kur një praktikë dëmton ose ka mundësi që të dëmtojë një fëmijë ose të ri, Child Protection Services (Shërbimet e Mbrojtjes së Fëmijës) mund të ndërhyjnë për të siguruar sigurinë dhe mirëqënien e tyre. Nëse ju ose dikush që ju njihni ka nevojë për mbrojtje nga dhuna apo abuzimi, ju duhet të kontaktoni policinë ose shërbimin e mbrojtjes së fëmijës.

Mbrojtja e fëmijës

**Child Abuse Prevention Service
(CAPS)** (Linja 24 Orëshe në rast krize)

1800 688 009

CAPS website

www.childabuseprevention.com.au

Martesa e detyruar në moshë të re

**International Social Service (ISS)
Australian Branch**

1300 657 843

ISS website

www.iss.org.au

Shëndeti dhe të drejtat riprodhuese të femrave

Praktika e gjymtimit (prerjes) të organit gjenital femëror, ose cilido veprim tjetër që ndryshon organet gjenitale femërore dhe që nuk bëhet për arsye shëndetësore, është ilegal në Australi. Gjithashtu është ilegale për të marrë ose dërguar një fëmijë në një vend tjetër për ta bërë një gjë të tillë, ose gjetja e një personi tjetër për ta organizuar këtë. Gratë dhe vajzat që vijnë në Australi mund të kenë probleme shëndetësore të shkaktuara nga kjo praktikë. Për t'i ndihmuar ato ka shërbime të veçanta të vleshme.

**Women's Information and Referral
Service (WIRS)**

1800 817 227

Website

www.women.nsw.gov.au/referral/wirs.htm

Drejtimi i Automjeteve

Për të ngarë çfarëdo lloj makine në Australi duhet të keni një patentë shoferi. Gjithashtu automjeti që drejtoni duhet të jetë e regjistruar në qeveri. Për informacione rreth patentave të automjeteve si dhe të regjistrimit të tyre, shikoni Kapitullin 1, *Çfarë duhet të bëni së shpejti pas mbërritjes*.

Mosbindja ose shkelja e ligjeve të trafikut mund të rezultojë në gjoba të mëdha, humbje të lejes së shoferit ose edhe burgim. Përdorimi i një celulari kur jeni duke drejtuar automjetin është kundër ligjit, nëse nuk jeni duke përdorur paisjen 'handsfree' që ju lejon të flisni pa mbajtur celularin në dorë.

Në të gjitha makinat ka rrypa (që quhen gjithashtu edhe 'restraints' frenuesa ose lidhëse) për rritur dhe fëmijë të rritur. Për fëmijët e vegjël dhe bebet kërkohet që të keni lidhëse speciale të aprovuara nga qeveria. Ligji thotë që gjithsecili në makinën tuaj duhet të përdorë një rryp ose karrige të përshtatëshme për fëmijë, dhe nëse merrn pjesë në një aksident në rrugë ju duhet të raportoni në polici menjëherë.

Shkelja e ligjeve të trafikut mund të sjellë gjoba të mëdha, humbjen e patentës së shoferit, bile edhe burgim. Përdorimi i celularit kur jeni duke drejtuar automjetin është kundër ligjit, nëse nuk përdoroni 'handsfree' (paisjen e ndigjimit që nuk kërkon që ta mbani telefonin në dorë).

Ka rripa sigurimi për të rritur, dhe fëmijë jo të vegjël që quhen ndryshe edhe 'restraints' – "pengesa" në çdo makinë. Ju duhet të keni një rrip të veçantë të aprovuar nga qeveria për fëmijët e vegjël dhe bebet. Ligji thekson se çdo njeri që udhëton në makinë duhet të mbajë rripin e sigurimit apo ulësen e duhur për fëmijët sipas moshave. Në se bëni aksident rrugor, duhet ta lajmëroni policinë menjëherë.

Në disa zoan është e mundur të merrni me qera karige sigurimi për fëmijë. Për të gjetur më shumë informacion në lidhje më këtë shërbim në zonën tuaj kontaktoni:

Kidsafe NSW

(02) 9845 0890

**Help in languages
other than English**

131 450

Website

www.kidsafe.com.au

Ligjet janë veçanërisht strikte për kufirin e shpejtësisë si dhe drejtimin e automjetit pas konsumimit të alkoolit. Nivelet e lejuara të alkoolit në gjak ndryshojnë në varësi të shtetit dhe territorit dhe në përputhje me klasin e patentës që ka shoferi. Është ilegale të pini alkool ndërsa drejtoni makinën. Për më shumë informacion kontaktoni:

Alcohol Guidelines

www.alcohol.gov.au

Metropolitan (Në qytet) (për të marrë
ndihmë për një çështje alkoli ose
droge)

(02) 9361 8000

Country (në Fshat) (për të marrë
ndihmë për një çështje alkoli ose
droge)

1800 422 599

Droga, duhani dhe pijet

Ka shumë ligje në lidhje me mbajtjen dhe përdorimin e drogës. Thyerja e ligjeve të drogës mund t'ju çojë **në dënime të rënda**. Ligjet e drogës në Australi janë të ndryshme për ato që përdorin drogat ilegale dhe për ato që janë në biznesin e furnizimit, prodhimit ose shitjes së tyre.

Pirja e duhanit ndalohet në një numër në rritje vendesh në Australi, duke përfshirë shumicën e zyrave qeveritare, klinikat shëndetësore dhe vendet e punës. Në shumicën e shteteve e territoreve pirja e duhanit është e ndaluar edhe në restorante e shitore. Ndalimi i duhanit tregohet shpesh, por jo gjithmonë me shenjën 'no smoking' (ndalohet duhani).

Shitja e produkteve të duhanit personave 'minor' (të mitur) (persona nën 18 vjeç) është kundravajtje për shitësat. Shitja e duhanit tek një person i moshës jo-madhore është e ndaluar në shumicën e shteteve dhe territoreve.

Pirja e alkoolit është veprim i ligjshëm në Australi por vetëm në vende të caktuara dhe në raste të caktuara. Një person që i shet alkool një personi të moshës jo-madhore nën moshën 18 vjeçare- një (i "mitur") kryen kundravajtje. Gjithashtu, është e jashtëligjshme për një person të moshës jo-madhore të pijë alkool jashtë pronave private siç është shtëpia e vet. Pirja e alkoolit ndalohet edhe në disa vende publike.

Australian Drug Information Network

(duke përfshirë informacion në gjuhët jo Anglisht)

www.adin.com.au

Mjedisi

Mjedisi i pastër dhe mbrojtja e natyrës janë shumë të rëndësishme për Australianët. Krijimi i mbeturinave, ndotjes dhe hedhja e tyre pa leje është e jashtëligjshme. Kafshët, peshqit, butakët dhe bimët e vendit janë të mbrojtura me ligj. Mos gjuani, zini peshk ose të mblidhni bimë ose butakë pa kontrolluar nëse keni nevojë për leje. Gjithashtu, ka rregulla të veçanta të cilat ruajnë [National Parks](#) (Parqet Kombëtare) nga dëmtimi.

Environment Line

(për informacion mbi parqet dhe raportimin e ndotjes)

13 1555

TTY (për shurdh memecat)

(02) 9211 4723

Zhurma

Ka ligje që mbrojnë Australianët nga zhurma e tepruar. Rregullat ndryshojnë ndërmjet shteteve dhe territoreve, dhe gjithashtu varen nëse zona është për përdorim kcomercial, industrial ose për banim. Në përgjithësi komshijtë i tolerojnë zhurmat e rralla, por nëse janë të shpeshta, tepër të larta ose ndodhin natën, kanë të drejtë të ankohen në këshillin lokal, në autoritetin e mjedisit të shtetit ose të territorit, ose në polici.

Kafshët

Australia ka ligje për mbrojtjen e kafshëve nga keqtrajtimi ose neglizhimi. Është e ndaluar të mbyten kafshët në oborrin e shtëpisë. Njerëzit që keqtrajtojnë kafshët dhe zogjtë mund t'ju vihet gjobë ose dhe mund të burgosen. Ka ligje lokale se si duhet të mbahen kafshët shtëpijake në shtëpi. Kafshët shtëpijake si qentë është e nevojshme të regjistrohen në këshillin tuaj lokal. Shikoni nën 'Dog' (Qeni) në 'Government' section (në Seksionin e Qeverisë) të numeratorit telefonik [White Pages](#).

Nëse merrni një kafshë shtëpijake ju jeni përgjegjës për përkujdesjen e saj duke përfshirë ushqimin dhe pastrimin e saj. Shumë kafshë shtëpijake duhet të vaksinohen rregullisht dhe të trajtohen nga një veterinar/e kur janë të sëmurë ose të plagosur. Di-seksimi dhe paisja e kafshëve shtëpijake me chip (paisje elektronike që vendoset rreth qafës së kafshës që detekton vendodhjen e saj nëse humbet) është diçka që ju pritet ta bëni në Australi dhe është përgjegjësi e të zotit. Ju mund të merrni më shumë informacion nga veterineri juaj lokal ose nga **Royal Society for the Prevention of Cruelty to Animals (RSPCA)** (Shoqëria Mbretërore për Parandalimin e Mizërisë ndaj Kafshëve).

Royal Society for the Prevention of Cruelty to Animals (RSPCA) NSW

(kërkesat dhe lajmërimet e rasteve të mizërisë ndaj kafshëve)

(02) 9770 7555

RSPCA NSW e-mail

(kërkesat e përgjithëshme)

mail@rspcansw.org.au

RSPCA website

www.rspca.org.au

Royal Society for the Prevention of Cruelty to Animals (RSPCA) NSW

(vetëm urgjencat)

(02) 97707556

Takimi dhe komunikimi me njerëzit

Kur takoni dikë për herë të parë, është normale ndërsa i shikoni ato në sy që t'i tokni dorën e djathtë me dorën tuaj të djathtë. Njerëzit që nuk njihen paraprakisht, zakonisht nuk puthen as nuk përqafohen kur takohen.

Shumë Australian, kur flasin me dike, e shikojnë bashkëfolësin në sy, si shenjë respekti dhe për ta lënë bashkëfolësin të kuptojë që po e dëgjon se ç'flet. Megjithatë, duhet ta keni parasysh, se shikimi drejt në sy gjatë bisedimit i bën disa njerëz ta ndjejnë vehten në siklet apo të turpërohen.

Kur Australianët takojnë dikë për herë të parë, ata mënjanojnë bërjen e pyetjeve direkte dhe personale si psh për moshën, martesën, fëmijët ose paratë.

Me përjashtim të rastit kur ju kanë prezantuar dike me emrin e tyre, apo në rast se ju kërojnë që t'i flisni me emrin e parë, është zakon t'ju flitet njerëzve me titullin e tyre dhe me mbiemrin. (P.sh. Mr. Wong – Zoti Wong. Ms Smith, - Zonjusha Smith, Mrs Brown – Zonja Brown, Dr Lee – Dr Lee). Zakonisht në vendin e punës përdoret vetëm emri i parë, gjithashtu Australianët kur flasin me shokë e shoqe thërrasin njeri tjetrin vetëm me emrin e parë.

Sjellja e hijshme

Australianët zakonisht thonë **“Please”** - “Të lutem” kur kërkojnë diçka ose ndonjë shërbim dhe thonë zakonisht edhe **“thank you”** “faleminderit” kur dikush i ndihmon ose u jep atyre diçka. Po të mos thoni “please” dhe “thank you” do të quhej sjellje e pahijshme.

Australianët thonë zakonisht **“excuse me”** “më falni” për t'ja tërhequr vëmendjen dikujt dhe **“sorry”** “më fal” kur ato përplasen padashje. Australianët e përdorin “excuse me” apo “pardon me” kur ato gromësojnë si dhe kur nxjerrin gazra me zhurmë pa dashje nga goja para njerëzve si në publik po ashtu edhe në shtëpi.

Duhet të përpiqeni të arrini në orar gjithmonë kur keni mbledhje apo takime të ndryshme zyrtare. Në se e shihni që do të vonoheni, përpiquni ta telefononi personin me të cilin keni lënë takim për të lajmëruar që do të vonoheni. Kjo gjë ka rëndësi të madhe kur keni takime zyrtare për arsye se mund t'ju thonë se duhet ta paguani kohën që jeni vonuar. Po ta harroni takimin zyrtar gjithashtu mund t'ju thonë ta paguani në se nuk lajmëroni paraprakisht që do të mungoni. Për një njeri që vjen gjithmonë me vonesë mund të krijohet përshtypja se tek ai / ajo nuk mund të kesh besim.

Nëse ju merrni një ftesë ajo mund të ketë të shkruara geramat ‘RSVP’ dhe një datë. Kjo do të thotë që personi që ju fton ju ka dëshirë të dijë nëse do të merrni pjesë ose jo. Në një rast të tillë është mënyrë e sjellshme të përgjigjeni deri me atë datë.

Shumica e Australianëve përdorin shami hundësh apo piceta prej letre për t'i fryrë hundët. Nuk i frynë përtokë apo në trotuarë. As nuk pështynë përtokë / trotuarë. Shumë njerëz do të thonë **“bless you”** kur të dëgjojnë që tështinë. Kjo shprehje nuk ka asnjë nënkuptim fetar.

Ka rëndësi ta dini që ka sjellje që jo vetëm quhen të pahijshme por janë edhe të kundraligjshme. Si shembull të sharat në vende publike, të shtyrit kur ndodhesh në rradhë si dhe urinimi apo dalja për nevojat e tjera personale kudo, përveç në WC-të publike apo private (nevojtoret).

Veshja

Shoqëria Australiane është e përbërë nga një shumëllojshmëri kombesh. Kjo gjë reflektohet në larminë e madhe të veshjeve. Shumë njerëz për rehati kanë tendencë të vishen në veshje të zakonshme ose joformale ose në përshtatje të situatës shoqërore ose klimës. Shumë njerëz gjithashtu zgjedhin sidomos në raste speciale të veshin veshje tradicionale që mund të jetë fetare ose siç e ka zakoni. Ato mund të përfshijnë veladonin e

murgut, byrden, shaminë që mbulon kokën dhe çallmën. Shumë emigrantë të ardhur rishtaz vendosin gjithashtu të mos veshin veshjen tradicionale.

Ka shumë pak ligje apo rregulla për mënyrën e veshjes, megjithatë, ka rregulla rreth mënyrës së veshjes në vendet e ndryshme të punës dhe në disa vende pune të veçanta. Për shembull, çizmet si dhe helmetat apo kasketa të forta duhet të vishen për arsye sigurimi në vendet e ndërtimit, për ta siguruar punëtorin nga rreziqet dhe policia, ushtria si dhe punonjësit e disa bizneseve mbajnë uniformë.

Klubet e ndryshme, kinematë, si dhe vende të tjera mund të kenë si kërkesë që anëtarët dhe klientët e tyre të vishen pastër dhe në mënyrë të rregullt., me këpucë apo sandale por jo shapka.

Disa modele veshjeje mund t'ju duken konfrontuese ose të pahijshme. Për shembull, disa gra veshin rroba që shfaqin shumë pjesë të trupit. Ju nuk duhet t'i gjykoni ato nga standartet e vendit tuaj të mëparshëm. Në Australi, ju nuk duhet të interpretoni duke u bazuar në modelin e fustanit të një gruaje që ato kanë morale të ulëta apo që dëshirojnë të tërheqin vëmendjen e burrave.

Shprehje të përditshme Australiane

Shumë shprehje të zakonshme apo të përditshme Australiane mund t'ju duken njerëzve që vijnë për herë të parë në Australi si të çuditshme. (Si pa kuptim). Nëse nuk jeni të sigurt për domethënjen e ndonjë shprehjeje mund të pyesni, nuk ka gjë. Po ju parashtrojmë disa shembuj të këtyre shprehjeve që mund të mos kuptohen

- **Bring a plate:** - kur ju ftojnë për të marrë pjesë në ndonjë gosti shoqërore apo edhe për të festuar së bashku me njerëzit e punës dhe ju thojnë “bring a plate”, do të thotë të sillni në gosti një pjatë të përgatitur me ndonjë ushqim për ta ndarë me të tjerët.
- **BYO** – kjo është shkurt për ‘Bring Your Own’ që do të thotë: sille me vehte pije. Mund të jetë alkool, pije feskuese apo ujë. Disa restorante janë BYO. Mund të sillni me vehte shishet e verës, megjithatë zakonisht kërkojnë para për gotat që ua japin edhe për larjen e tyre, kjo lloj pagese për shërbimin e gotave quhet: ‘corkage’.
- **Fortnight** – një ‘fortnight’ është një periudhë dy-javore. Shumë njerëz në Australi marrin rrogen një herë në dy javë.

6. Strehimi

Qiramarrja e shtëpive private ose apartamenteve

Marrja me qera e një shtëpie apo apartamenti zakonisht bëhet nëpërmjet një real estate agent (agjenti për shitblerjen dhe lëshimin me qira të pronave të paluajtshme) që veprojnë në emër të zotit të shtëpisë ose mund të merrni me qera direkt nga i zoti privat i shtëpisë. Pronat që jepen me qira reklamohen në gazeta sidomos të Mërkurave dhe të Shtunave nën seksionet 'To let' dhe 'Accommodation vacant'. Ju mund të shkoni edhe në zyrat e real estate dhe kërkoni të shikoni listën vlefshme të shtëpive që kanë ata gati për t'u dhënë me qira. **Strehimi në Australi mund të jetë i vështirë të gjendet dhe qiraja mund të jetë shumë e kushtueshme.**

Në Australi, preferohet që të ketë një marrëveshje me shkrim ndërmjet një qiramarrësit dhe qiradhënësit në mënyrë që të identifikohen më lehtësisht kushtet e kontratës.

Një 'lease' (kontratë qiradhënie) ose një "marrëveshje qiramarrje për banim" është një kontratë me shkrim e bërë ndërmjet qiramarrësit dhe qiradhënësit dhe zakonisht është për një periudhë fikse prej 6 ose 12 muajsh, mirëpo para se të nënshkruani ju keni të drejtë të negocioni kohëzgjatjen e qerasë me qiradhënësin ose me agjentin e tij. Mund të jetë e mundur që të përtërin qeranë në fund të periudhës së fiksuar.

Mund t'ju kushtojë nëse e thyni qeranë para afatit të caktuar me të cilën keni rënë dakord, prandaj mos e përkushtoni veten tuaj me një qera që është për një periudhë kohe më të gjatë se ju mund të qëndroni. **Mos nënshkruani kontratën pa e inspektuar pronën dhe pa i kuptuar plotësisht kushtet e parashtruara në dokument, sepse pas nënshkrimit jeni të lidhur nga ana ligjore në bazë të pikave dhe kushteve të asaj kontrate.** Për më shumë informacion shikoni *më poshtë Tenants' rights and responsibilities* (Të drejtat dhe përgjegjësitë e qiramarrësve).

Në fillim të qiramarrjes në përgjithësi do t'ju kërkohet të paguani një muaj qera paradhënie si dhe një depozitë të quajtur 'bond'. Bond-i është një depozitë që i paguhet qiradhënësit dhe në përgjithësi nuk duhet të jetë më shumë sa vlera e një muaji qera. I zoti i shtëpisë ose agjenti i shtëpijave duhet ta vendosin këtë bond pranë Residential Tenancies Bond Authority (Autoriteti për Bondet e Qiramarrjeve Rezidenciale).

Para se të hyni në shtëpi gjendja e banesës është e rekorduar në një dokument të quajtur 'condition report' (raporti i gjendjes së banesës) dhe është i plotësuar nga ju dhe qiradhënësi ose agjenti i tyre. Ky dokument mund të ndihmojë që të mënjanoni ndonjë mosmarrëveshje kur të delni nga banesa për arsye se aty janë rekorduar të gjitha dëmtimet që kanë qënë aty kur ju keni hyrë në banesë fillimisht. Nëse kur të largoheni nga shtëpia ose apartamenti me qera nuk keni lënë qera të papaguar dhe e lini pronën të pastër dhe pa dëmtime ju e merrni depozitën mbrapa.

Ju mund të jeni i/e ligjeshme për asistencë financiare për t'ju ndihmuar që të përballoni koston e depozitës dhe të muajit të parë paradhënie në qera. Ju mund të jeni të ligjshëm gjithashtu edhe për **Rent Assistance** (Ndihmë me Qeranë) që mund t'ju ndihmojë për të plotësuar pagesën e qerasë. Informacioni rreth këtyre pagesave është i vlefshëm nga Centrelink.

Në NSW (Uellsin e Ri Jugor) **Department of Housing (Departamenti i Strehimit)** i ndihmon njerëzit me të ardhura të ulta nëpërmjet skemave të asistencës për qiranë si p.sh. [RentStart](#). Kjo mund të përfshijë ndihmë kundrejt 'bond'-it (depozitë që mbahet nga pronari në rast se qiraxhinjët dëmtojnë banesën, por kthehet kur banesa është mirëmbajtur), 'advance rent' (parapagimi i qirasë), pagesën e një strehimi të përkohshëm dhe për qeranë e vonuar. Në përgjithësi, RentStart assistance do të kontribuojë deri në 75% të koston së bondit (depozitës).

- Njerëzit në rrethana të rënda financiare dhe strehimi mund të kenë të drejtë për Rentstart Plus dhe mund t'ju jepet ndoshta pagesa e plotë e bond-it;
- deri në 2 javë qera e parapaguar (3 javë për një strehim të mobiluar) dhe;
- deri në katër javë qera në banesë të përkohëshme.

Për të patur të drejtë për Rentstart Standard, Rentstart Plus, and Rentstart Tenancy Assistance klientët duhet të:

- synojnë të qëndrojnë në atë vend dhe qiramarrja të mbahet për deri në 12 muaj

Që t'ju takojë me ligj RentStart, klientët duhet të:

- jenë nënshetas Australian ose banorë të përhershëm, ose të kenë një Temporary Protection Visa (Vizë Mbrojtëse e Përkohëshme) ose të jenë persona që kërkojnë azil politik të cilët kanë bërë aplikim për t'u bërë banorë të përhershëm;
- t'i plotësojnë kriteret e të ardhurave të parashtruara nga strehimi publik,
- t'i plotësojnë kriteret e pasurive të parashtruara nga strehimi publik,
- të kenë para në gjendje në sasi të kufizuar, zakonisht më pak se \$1000; dhe
- të jenë në gjendje të përballojnë qiradhënen në tregun privat të shtëpive.

Ka disa përjashtime për disa nga kriteret për aplikantët e Rentstart Move. Në disa pjesë të New South Wales-it, shumica e produkteve të Rentstart Standard dhe Rentstart Plus janë të vlefshme nëpërmjet Shërbimit Rentstart në Telefon , ato janë:

- deri në pagesën e plotë të bond-it;
- deri në 2 javë qera e parapaguar (3 javë për një strehim të mobiluar);
- deri në katër javë qera të vonuar; dhe
- deri në 3 netë qera në banesë të përkohëshme.

Për vendndodhjen e zyrave që kryejnë kërkesat për Rentstart nëpërmjet telefonit vizitoni www.housing.nsw.gov.au

Për informacion rreth RentStart-it, kontaktoni:

Department of Housing Kërkesa të Përgjithëshme
(24 orët e ditës, 7 ditët e javës)

1800 629 212

Website

www.housing.nsw.gov.au/

Numrat telefonik të Departamentit të Strehimit lokal gjenden në numërorin [White Pages](#) nën titullin 'Housing Dept. of'. Ose shkoni në faqen e internetit të Departamentit www.housing.nsw.gov.au .

Të drejtat dhe përgjegjësitë e qiraxhinjëve

Në New South Wales, të zotët e shtëpive ose agjentët e tyre të shit-blerjes së pronave duhet t'u japin të gjithë qiramarrësve një kopje të broshurës '[The Renting Guide](#)', botim i **Office of Fair Trading** (Zyra e Tregtisë me Përfitim Reciprok). Kjo broshurë shpjegon të drejtat dhe përgjegjësitë e qiraxhinjëve dhe është e vlefshme në një numër gjuhësh. Sigurohuni që të merrni një kopje. Për më shumë informacion kontaktoni:

[Office of Fair Trading](#)

133 220

(fair trading enquiries) (pyetjet për tregtinë e barabartë)

1300 723 404

TTY (for hearing and speech impaired)
(për shurdh memecët)

[Tenants' Union Hotline](#)

1800 251 101

Blerja e shtëpive private ose apartamenteve

Shtëpitë apo apartamentet në shitje zakonisht reklamohen në gazetë dhe mund të reklamohen në internet gjithashtu. Agjensitë e shitblerjes së tyre gjithashtu mund t'ju japin një listë të pronave që ato kanë në shitje. Nëse jeni duke blerë shtëpi për herë të parë në Australi ju mund të jeni të ligjshëm për një 'First Home Owner Grant' i Qeverisë Australiane (Subvencionim për ato që Blejnë për Herë të Parë Shtëpi).

Nëse keni nevojë të merrni para hua për të blerë një pronë duhet të kontaktoni bankën apo institucione të tjera financiare. Njerëzit në Australi zakonisht përdorin një avokat kur blejnë një pronë, që të kontrollojë tapinë dhe dokumentet. Përsëri, **mos nënshkruani kontratën nëse nuk i kuptoni të gjithë kushtet e vëna në të.**

Nëse doni këshilla mbi hapat në blerjen e një shtëpie, dhe se ç'skema për ndihmë ju ofrohen nga qeveria, [Home Purchase Advisory Service](#) (Shërbimi Këshillues për Blerjen e Shtëpisë) ofron informacion falas, këshilla dhe referime mbi çështje që lidhen me blerje siç janë blerja, ndërtimi, sigurimi i financës për shtëpi. Ky shërbim ka nxjerrë një seri botimesh falas siç janë "The A-Z of Home Purchase" ("Nga A-ja deri tek Z-ja për blerjen e Shtëpisë") si dhe "Financing Your Home Purchase" ("Financimi i Blerjes së Shtëpisë").

Për të folur me një këshilltar për blerje shtëpijash ose për fituar kopje të botimeve të mësipërme dërgojuni atyre një e-mail, ose telefononi shërbimit gjatë orëve të punës në numrin Falas:

[Home Purchase Advisory Service](#)

1800 806 653

Home Purchase Advisory Service
Email

advisory@housing.nsw.gov.au

NSW Housing website

www.housing.nsw.gov.au/

Që të bisedoni me një këshilltar për blerjen e shtëpisë ose që të siguron kopje të të gjitha botimeve të lart përmendura, telefononi shërbimin gjatë orëve të punës (9 deri në 5) në numrin Falas:

[Home Purchase Advisory Service](#)

1800 806 653

NSW Housing website

www.housing.nsw.gov.au

Strehimi nga Qeveria

Nëse ju merrni pagesë nga Centrelink ose keni të ardhura shumë të ulëta ju mund të aplikoni të merrni me qira banesa shtetore. Koha e pritjes për banesë shtetore ndryshon në bazë të vendit ku ju doni të jetoni, madhësia e familjes suaj dhe urgjenca e nevojës suaj për strehim.

Në NSW, Department of Housing (Departamenti i Strehimit) jep me qira edhe banesat e veta shtetore për njerëzit me të ardhura të pakta kundrejt qirave të subvencionuara. Për këtë lloj banese koha e pritjes është e gjatë, por në disa rrethana mund të jepet zgjidhje më e shpejtë.

Në dritën e reformave të kohëve të fundit në banesat e shtetit, e drejta për tu strehuar në këto banesa ka ndryshuar duke u përqëndruar në:

- ndihmimin e njerëzve me të ardhura të vogla që kanë nevojë për mbështetje për t'i ndihmuar ato të jetojnë të pavarur; dhe
- njerëzit që kanë probleme në gjetjen e një strehimi që mund ta paguajnë në tregun e qirasë private dhe që është i përshtatshëm për nevojat e tyre.

Ky ndryshim do të thotë një largim nga përdorimi i të ardhurave si kriter kryesor i të drejtës për strehim publik dhe përfshirjen e një vlerësimi të nevojave dhe aftësisë për të gjetur strehim që njerëzit janë në gjendje ta paguajnë.

'Community housing' është i ngjashëm me 'public housing'. Ajo drejtohet nga organizata që nuk kanë asnjë përfitim ekonomik në vend që të Departamentit të Strehimit. Office of

Community Housing (Zyra e Banesave të Komunitetit) sponsorizon shoqata të strehimit, ko-operativa, kisha, organizatat qeveritare dhe të tjera joqeveritare që të ofrojnë strehim me qira të arsyeshme për njerëzit që janë me të ardhura të pakta. Shumica e banesave të 'community housing' (strehimi i komunitetit) përdoren për strehim afatgjatë për njerëz me të ardhura të pakta të cilët paguajnë 25 përqind të të ardhurave të tyre për qiranë. Për informacion për strehimin e qeverisë/komunitetit kontaktoni:

Department of Housing
General Enquiries

1800 629 212

Numrat e Zyrës lokale të Departamentit të Strehimit ndodhen të shënuara nën 'Housing Dept of' në numërorin telefonik të [White Pages](#).

Strehimi I Përkohshëm Urgjent

Në NSW Departamenti i Strehimit mund t'i ndihmojë njerëzit të cilët ndodhen në krizë afatshkurtër të strehimit duke ju dhënë strehim të përkohshëm shtetor ose privat deri në tre muaj.

Strehimi i Përkohshëm jepet vetëm për ata njerëz:

- të cilëve nuk u takon me ligj strehimi nga shteti, dhe
- kanë nevojë urgjente për strehim për një afat të shkurtër, dhe
- nuk janë në gjendje ta përballojnë këtë nevojë vet, dhe
- nuk mund të gjejnë strehim tek ndonjë anëtar i familjes apo shok/shoqe,
- nuk ju takon nga ana ligjore ndonjë formë tjetër ndihme nga agjensi të tjera për shkak të të ardhurave ose të statusit residencial të përkohshëm.

Për informacion rreth strehimit të përkohshëm urgjent, kontaktoni:

Department of Housing Kërkesat e Përgjithëshme

1800 629 212

Numrat telefonik të Zyrës lokale e Departamentit të Strehimit gjenden në numërorin [White Pages](#) nën 'Housing Dept of'.

Supported Accommodation Assistance Program

The Supported Accommodation Assistance Program (SAAP) (Programi i Asistencës për Strehim) siguron strehim "tranzicional" (të përkohshëm) dhe shërbime mbështetje të ngjashme për njerëzit që janë pa strehë apo rrezikohen të mbeten pa strehë. Programi zbatohet nga një sërë organizatash jo qeveritare dhe të financuara nga Department of Community Services (DoCS) (Departamenti i Shërbimeve të Komunitetit) në të dy nivelet e Shtetit dhe të Komonuelthit. Për informacione të tjera rreth shërbimeve të SAAP-it për të pastrehët kontaktoni:

Homeless Persons Information Centre (HPIC)
(Qendra Informative për të Pastrehët)

1800 234 566

Për persona që përballohen me dhunë nga një bashkëshort etj, në shtëpi të cilët kanë nevojë për ndihmë urgjente, (ku përfshihet këshillimi me psikolog si dhe referimet), kontaktoni Department of Community Services (Departamentin e Shërbimeve të Komunitetit në numrin:

**NSW Department of Community
Services 24-Hour Domestic Violence
Line**

1800 656 463

TTY (për shurdh/memecat)

1800 671 442

Linja Telefonike për të Rinjtë që Kërkojnë Strehim Urgjent

Kjo linjë u ofron informacion me anë të telefonit si dhe shërbime referuese (ju tregon se ku mund të shkoni) për të rinjtë që kanë mbetur pa strehë. Gjithashtu u ofron një list të krevateve bosh për të cilët zihet rradha në rastin më kritik të mbetjes jashtë. Lista ndryshon çdo ditë sipas krevateve që bëhen vakant nga e Hëna deri të Premten. Për më shumë informacion telefononi:

Linjën e Strehimit të Rasteve Urgjente për të Rinjtë

(Zonat e Fshatit)

1800 424 830

Youth Accommodation Association NSW

9318 1531

Shërbimet shtëpijake të Domosdoshme

Edhe nëse jetoni me qira ose bleni, janë një numër shërbimesh shtëpijake që mund t'u duhet të keni të lidhur në shtëpinë tuaj. Përpquni që t'u jepni atyre që sigurojnë këto shërbime njoftim pak ditë përpara se të lëvizni diku tjetër.

Përpara se të nënshkruani një kontratë për shërbimet në lidhje me banimin, ju duhet të kontrolloni që shërbimi me të cilin po lidheni është i nevojshëm për kushtet tuaja të banimit. Në disa raste njerëzit kanë nënshkruar një kontratë për 3 vjet për furnizim me energji, megjithëse ato jetonin në një banesë të përkohëshme dhe për më pak se tre vite. Është e rëndësishme të kuptoni kushtet e marrëveshjeve me furnizuesit e këtyre shërbimeve përpara se të bëni ose nënshkruani ndonjë kontratë për shërbimet në lidhje me banimin.

Electricity, Gas and Water - Elektri, Gazi dhe Uji

[Energy Australia](#)

(në Sidnein Lindor, Bregdetin Qendror dhe Newcastle)

13 1535

[Integral Energy](#)

(Në Sidnein Perendimor dhe Wollongong)

13 1002

[AGL](#)

13 1245

[Sydney Water](#)

(Në Sidnei, Malet Blu dhe Illawarra)

13 2092

[Hunter Water](#)

(Në Rajonin e Hunter-it)

1300 657 657

Telefonat

Kompanitë e telefonave, duke përfshirë Kompaninë pjesërisht publike, janë të rreshtuara në numërorin telefonik [Yellow Pages](#) (Faqet e Verdha) nën 'Mobile telephones and accessories' (Telefonat celularë dhe pjesë) dhe 'Telephones – long distance' (Telefonat - distanca të gjata)

Disa prej këtyre shërbimeve mund të kërkojnë një shumë për lidhjen e telefonit në fillim. Ju lutemi sqaroheni këtë gjë me kompaninë që siguron shërbimin e lidhjes telefonike (p.sh. Telstra) para se të nënshkruani kontratën me ta. Ata do t'ju dërgojnë rregullisht një faturë ku janë shënuar çmimet për secilin prej shërbimeve të tyre që keni përdorur. Ju duhet t'i kontaktoni menjëherë nëse nuk keni mundësi ta paguani faturën në datën e caktuar, ose nëse preferoni që në vend që të merrni fatura të mëdha në intervale kohe më të gjata, të merrni fatura më të vogla më shpesh. Thirrjet telefonike me vende jashtë Australisë mund të jenë të kushtueshme dhe shumica e faturës së telefonit mund të rritet shumë shpejt. Do t'ju

duhet t'i monitorizoni me shumë kujdes thirrjet me jashtë ose përdorni karta thirrjesh telefonike të parapaguara (të vlefshme nga gazetashitësit).

Shumë njerëz në Australi kanë celularë, mirëpo, thirrjet e bëra nga celularët mund të jenë shumë të shtrenjta. Kur përdorni celularët ose kur bëni thirrje ndërmjet shteteve të Australisë ose thirrje ndërkombëtare në përgjithësi thirrjet maten me minuta ose njësi 30 sekondash. **Ju duhet të kujdesoheni që kuptoni plotësisht detyrimet financiare dhe ligjore përpara se të vendosni të blini një celular.**

Telecommunications Industry Ombudsman (Ombudsmani i Industrisë së Telekomunikacionit) ka prodhuar një numër fletushkash mbi shumëllojshmërinë e çështjeve të konsumatorit të vlefshme në Anglisht dhe në një numër gjuhësh të tjera. Për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit ose kontaktoni:

Telecommunications Industry Ombudsman

1800 062 058

Website

www.tio.com.au/publications/FactSheets.htm

7. Punësimi

Kërkimi i punës

Marketi Australian i punës mundet të jetë shumë konkurrues. Se sa shpejt gjejnë punë të sapoardhurit nga vendet e tjera varet nga faktorët ekonomikë, kualifikimet dhe aftësitë, natyra e punës që kërkojnë dhe rrethanat e veçanta që mund të ndikojnë vlershmërinë e disa tipeve punësh në pjesë të ndryshme të vendit.

Gazetat e përditshme reklamojnë 'Job vacancies' (Vendet e punës) (ose 'Positions vacant' (Vendet e lira)), sidomos të Shtunave. Vendet e lirshme të punës mund të gjenden edhe në internet. Në numërorin '[Yellow Pages](#)' dhe në bordet e punësimit të internetit gjithashtu janë të shënuara edhe agjensitë private të punësimit .

Çdo banor Australian mund të regjistrohet me **Centrelink** dhe **Job Network** ku mund të ndihmohet të gjejë punë. Pas regjistrimit ju rekomandoheni tek **Job Network** (Rrjeti i Punës), që përbëhet nga organizata private, të komunitetit apo të qeverisë, të kontraktuara nga Qeveria Australiane që ti ndihmojnë njerëzit të gjejnë punë.

Si i/e sapoardhur, shpesh është ide e mirë të bisedoni me një këshilltar/e punësimi me eksperiencë ose me dikë në **Centrelink Career Information Centre** (Qendra Informativë e Centrelink për Karrierat) për t'u siguruar që mënyra juaj e të kërkuarit punë është e përshtatshme, veçanërisht nëse ju hasni në vështirësi për t'u marrë në intervistë.

Të dhënat kontaktuese të Centrelink

| | |
|--------------------------------------|--|
| Job Search Information Line | 13 6268 |
| Ndihmë në gjuhët jo Anglisht | 13 1202 |
| Në person | Vendndodhjet e Zyrave |
| Informacion në gjuhë të tjera | Ndihma në Centrelink-ne flasim gjuhën tuaj |
| Faqja e Internetit | www.centrelink.gov.au |

Job Network services (shërbime të Rrjetit të punës)

Nën Job Network (Rrjeti i Punës) gjenden një numër shërbimesh punësimi. Këto përfshijnë:

- **Job Search Support Services** (Shërbime për t'ju Ndhmuar në Gjetjen e Punës) – Ky shërbim ju ofrohet personave që kërkojnë punë që i plotësojnë kushtet, menjëherë sa të regjistrohen me Centrelink ose me një nga shërbimet për gjetje të punës. Ky shërbim ka për qëllim t'i ndihmojë njerëzit të gjejnë punë sa më parë,
- **Intensive Support Services (Shërbimet e Përkrahjes Intensive)** – ofron ndihmë përsëri për personat në kërkim të punës (që i plotësojnë kushtet) ku përfshihet trajnimi për t'u aftësuar për paraqitjen e vehtes gjatë intervistës për punë me punëdhësin.
- **Intensive Support (Përkrahje Intensive) – Job Search Training (Trajnim për kërkim të punës)**- përfshin ofrimin e ndihmës për punësim në përshtatje të çdo individi, përkrahje kjo që ju ofrohet atyre personave që plotësojnë kushtet. Këtu përfshihet edhe përmirësimi i Job Search skills (Aftësimi të tyre për të Kërkuar punë) vetë, si dhe zgjerimi i Job Search Networks (Rrjeteve për Kërkimin e Punës) (aktivitetet përfshijnë ndihmë në përgatitjen e resumesë (historikut të arsimimit dhe të punësimit) dhe të aftësimi të personave që trajnohen, në drejtim të aplikimeve të tyre për punë).
- **Përkrahja Intensive – ndihmë në përshtatje të klientit**- ofron më tepër ndihmë vetëm për vetëm me instruktorin për personat që i plotësojnë kushtet. Pikësynimi

është gjetja e pengesave që has individi kur kërkon punë. Njëkohësisht kjo përkrahje i drejton përpjekjet e punë-kërkuesit gjatë kërkimit të punësimit; dhe

- **New Enterprise Incentive Scheme – Skema e krijimit të ndërmarrjeve të reja (NEIS)** ndihmon personat që janë pa punë ta fillojnë dhe ta drejtojnë biznesin e tyre. Pjesëmarrësit e kësaj skeme mund të marrin ndihmë NEIS që ofron training për biznese të vogla, ndihmë financiare dhe këshilla gjatë vitit të parë të biznesit.
- **Assessment Fee Subsidy for Overseas Trained Australian Residents** (Subvencionimi i Pagesës së Vlerësimit për Banorët Australianë të Shkolluar jashtë shtetit) – ndihmon me koston e provimeve dhe vlerësimeve.

Është e rëndësishme të kujtoni që vetëm regjistrimi me një anëtar të Job Network nuk ju garanton punën. Ju duhet të jeni vazhdimisht në kërkim të punës në mënyrë që t'i rrisni mundësitë tuaja ta gjetur atë.

Të gjithë punë-kërkuesit mund të përdorin gjithashtu pajisjet falas të **Job Network Access** në Centrelink. Një numër i agjencive anëtare që merren me gjetjen e punës për njerëzit ofrojnë përdorimin e telefonave, fotokopjuesave, faksave, kompjuterave (duke përfshirë dhe internetin). Për më shumë informacion mbi shërbimet, si dhe për kushtet se kujt i takojnë me ligj këto shërbime, kontaktoni:

Job Seeker Hotline **13 6268**
Job Network website www.jobnetwork.gov.au

Centrelink-u gjithashtu rekomandon klientët për njohjen e kualifikimeve të marra në vende të tjera dhe jep këshilla rreth shërbimeve të tjera për punësim që gjenden në zonën lokale.

Zyrat e Centrelink-ut ndodhen në shumicën e lagjeve të qytetit si dhe në qendrat kryesore të fshatrave. Vendndodhja e tyre është e shënuar nën 'Centrelink' në numërorin telefonik White Pages dhe në faqen e internetit Centrelink.

Më shumë informacion

Australian Apprenticeships (Çirakët Australianë) **13 3873**
Website www.australianapprenticeships.gov.au
Workplace website www.workplace.gov.au
Australian Jobsearch website www.jobsearch.gov.au
Skilled Migrant Job Seeker website <https://skilledmigrant.gov.au>
Jobguide website www.jobguide.deewr.gov.au

Kualifikimet

Është e këshillueshme që të bëni përpjekje që t'ju njihen kualifikimet formalisht në mënyrë që të përmirësohet mundësia për të punuar në të njëjtin profesion për të cilin jeni kualifikuar.

Kualifikimet për zanatet

Nëse ju keni kualifikime në fushat si inxhinieri, ndërtim, metalurgji, elektricitet apo tregtitë e furnizimeve, intitucionet e poshtëshënuara mund t'ju këshillojë se si t'ju njihen këto kualifikime në Australi. Në se jetoni në Queensland kontaktoni:

Trades Recognition Australia

GPO Box 9879
MELBOURNE VIC 3001
Tel: **(03) 9954 2537** or **1300 360 992**
Fax: (03) 9954 2588
Web: www.workplace.gov.au/tra

Vocational Training Tribunal

Level 12
1 Oxford St
DARLINGHURST NSW 2010
Tel: **(02) 9266 8450**
Email: ARTCenquiries@deewr.gov.au
Web:
<http://apprenticeship.det.nsw.edu.au>

Për ata që ndodhen jashtë Australisë, pyesni në adresën dhe numrin që vijon:

Trades Recognition Australia

GPO Box 9879
CANBERRA ACT 2601
AUSTRALIA
Tel: +612 6121 7456
Fax: +612 6121 7768
E-mail: traenquiries@dewr.gov.au
Website: www.workplace.gov.au/tra

Department of Education, Employment and Workplace Relations (DEEWR)

(Departamenti i Arsimit, Punësimit dhe Marrëdhënieve të Punës) (DEEWR) nëpërmjet **Australian Education International - National Office of Overseas Skills Recognition (AEI-NOOSR)** (Arsimimi Ndërkombëtar Australian – Zyra Kombëtare e Njohjes së Profesioneve të marra Jashtë Shtetit) (AEI-NOOSR) japin informacion dhe këshillim me pagesë mbi krahasimin e kualifikimeve të marra jashtë shtetit. Për më shumë informacion kontaktoni:

Industry Training Services Centres (ITSCs)

(Qendrat e Shërbimeve për Trainimin në Industri)

13 2811

ITC-të gjenden në disa vende duke përfshirë Wollongong, Wagga Wagga, Orange, Tamworth, Lismore, Newcastle, Chatswood, Parramatta, Liverpool, Bankstown, dhe Sydney

Parramatta ITSC

Ground floor, 16-18 Wentworth St
PARRAMATTA 2150
Tel: 13 2811

Bankstown ITSC

2nd floor, 41-45 Rickard Rd
BANKSTOWN 2200
Tel: 13 2811

(Njohja e studimeve të mëtejshme)

TAFE i NSW mund t'ju njohin kualifikimet dhe zanatet e fituara jashtë shtetit në drejtim të hyrjes në kurset e tyre dhe për advanced standing. Për më shumë informacion kontaktoni:

TAFE NSW Information Centre

13 1601

TTY (for speech and hearing impaired)

(02) 8289 4703

Ju duhet t'i përktheni dokumentet e kualifikimeve tuaja nëse ato nuk janë në Anglisht. Shikoni Chapter 2, *Help with English*.

Kualifikimet e larta

Nëse ju jeni duke kërkuar për punë në një zanat të veçantë, kontaktoni regjistrimin, lejen ose trupin profesional të regjistruar në faqen e internetit Australian Skills Recognition Information (Informacioni Australian mbi Njohjen e Profesioneve).

Overseas Qualifications Units (OQU) (Njësitë e Kualifikimeve Jashtë Shtetit) ndihmojnë emigrantët të fitojnë pranimin e profesioneve dhe kualifikimeve të fituara jashtë shtetit. Për më shumë informacion shkoni tek:

Australian Education International - National Office of Overseas Skills Recognition (AEI-NOOSR) (Zyra Kombëtare-Ndërkombëtare Australiane e Arsimit për Njohjen e Kualifikimeve të Fituara në Vende jashtë Australisë) jep informacion se si t'ju njihen në Australi kualifikimet akademike të arsimit të lartë që keni marrë në vende jashtë Australisë. Për më shumë informacion kontaktoni:

AEI-NOOSR Hotline

1300 363 079

AEI-NOOSR website

aei.gov.au/AEI/QualificationsRecognition

Shënim: Ju lutemi kontrolloni me Overseas Qualifications Unit (OQU) (Njësinë e Kualifikimeve Jashtë Shtetit) përpara se të kontaktoni AEI-NOOSR; OQU do t'ju rekomandojë nëse është e nevojshme.

Në disa raste profesionistët që kanë kryer studimet jashtë Australisë të cilët gëzojnë nënshtetësinë Australiane ose janë me rezidencë të përhershme, mund t'ju takojë me ligj të përfitojnë ndihmën FEE-HELP për të paguar një pjesë ose të gjithë pagesën për studime mëtejshme që kërkohen për njohjen në Australi të studimeve profesionale të kryera jashtë shtetit.

FEE-HELP

1800 020 108

Going to Uni website

www.goingtouni.gov.au

ASDOT jep ndihmë financiare për të mbuluar koston e vlerësimit të kualifikimeve dhe provimet për profesionistat e trenuar jashtë shtetit në disa profesione që plotësojnë kriteret e ligjshmërisë së programit.

ASDOT Hotline

1300 363 079

ASDOT website

aei.gov.au/AEI/QualificationsRecognitionInformation/Asdot

Nëse dokumentet për kualifikimet tuaja nuk janë në Gjuhën Angleze, ju duhet ti përktheni. Shihni *Kapitullin 2, Ndihmë me Anglishten*.

Kushtet e punës (të drejtat e punëdhënësit/ punonjësit)

Punëtorët në Australi kanë të drejta dhe ju jepet e drejta e mbrojtjes nën ligjet përkatëse të federatës dhe shtetit/territorit. Këto ligje vendosin rregulla si pagesa minimale dhe minimumi i kushteve të punës për të cilat punonjësit kanë të drejtë.

Workplace Authority (Autoriteti i Vendit të Punës) është pika qendrore e kontaktit për këshillim dhe informacion falas mbi sistemin e marrëdhënieve Australiane të punës si për punëdhënësit ashtu dhe për punonjësit. Workplace Authority pranon gjithashtu dhe dorëzimin e marrëveshjeve të punës dhe vlerëson nëse këto marrëveshje janë të drejta. Workplace Authority gjendet në çdo kryeqytet dhe mund të kontaktohet me telefon nëpërmjet Translation and Interpreting Service (Shërbimit të Përkthimit).

Nëse nuk jeni të sigurtë se si aplikohen këto ligje në vendin tuaj të punës **Workplace Ombudsman** (Mbledhësi i Ankesave të Vendit të Punës) mund të hetojë ankesat ose shkeljet e dyshuara të ligjit federal të vendit të punës; të hetojë në çdo veprim apo praktikë që mund të jetë në kundërshtim me ligjin federal të vendit të punës; të fillojë veprimet gjyqësore që të detyrojë zbatimin e ligjit federal të vendit të punës; dhe përfaqëson punonjësit që janë ose mund të bëhen palë e veprimeve gjyqësore nën *Workplace Relations Act 1996* (Aktin e Marrëdhënieve të vendit të punës të vitit 1996).

Për më shumë informacion rreth sistemit të marrëdhënieve të punës në Australi ju mund të kontaktoni gjithashtu dhe Workplace Infoline (Linjën e Informacionit të Vendit/ të Punës) ose shkoni tek faqja e internetit e Australian Government's Workplace.

| | |
|--|--|
| Workplace Ombudsman website | www.wo.gov.au |
| Ndihma Shumëgjuhëshe në gjuhët e tjera jo Angleze | 13 14 50 |
| Workplace Ombudsman Helpline | 1300 724 200 |
| Workplace Infoline | 1300 363 264 |
| NSW Federal Wage Line | 1300 363 264 |
| Workplace website | www.workplace.gov.au |

Sipas Aktit të Marrëdhënieve të Punës të gjithë punonjësit kanë të drejtë që të anëtarësohen ose jo në një 'union' (sindikata punëtorësh). Një punëdhënës nuk mund të largojë nga puna një punëtor për arsye se ato i përkasin ose nuk i përkasin një unioni. Për më shumë informacion, kontaktoni **Australian Council of Trade Unions (ACTU)** (Këshillin Kombëtar të Unioneve).

| | |
|----------------------|--|
| ACTU Helpline | 1300 362 223 |
| ACTU website | www.actu.asn.au |

Superannuation (Pagesat e Detyruara nga Punëdhënësi për Pensionim)

'Superannuation' është një investim afatgjatë i projektuar veçanërisht për daljen tuaj në pension. Superannuation njihet në botë edhe si 'kursimet e pensionit' ose 'të ardhurat e pensionit'. Investimi në superannuation gjatë kohës që ju punoni është projektuar për t'ju ndihmuar të ndërtoni kursimet për pensionin tuaj. Pothuajse çdo njeri i punësuar në Australi është anëtar i një fondi për superannuation.

Superannuation në Australi njihet në përgjithësi si 'Super'.

Në shumicën e rasteve, në bazë të ligjit punëdhënësi i juaj është i detyruar të derdhë një shumë baraz me nëntë për qind (9%) të të ardhurave tuaja në një fond të zgjedhur nga ju për 'superannuation'. Edhe ju mund të kontribuoni para në Super-in tuaj. Për të parë në se punëdhënësi i juaj paguan shumën e duhur të parave, duhet të kontrolloni me njerëzit që drejtojnë fondin tuaj të 'superannuation'. Për më shumë informacion, kontaktoni:

| | |
|--|--|
| ATO Superannuation Infoline | 13 1020 |
| ATO website | www.ato.gov.au/super |
| Australian Securities & Investments Commission (ASIC) | 1300 300 630 |
| ASIC website | www.fido.asic.gov.au |

Taksimi

Një [Tax File Number \(TFN\)](#) (Numër Takse) është një numër i veçantë që iu lëshohet individëve ose organizatave nga **Australian Tax Office (ATO)** (Zyra Australiane e Taksave) dhe nevojitet për të gjitha format e marrjes së të ardhurave. Jepini përparësi aplikimit për TFN. Mënyra më e shpejtë për ta siguruar TFN (Numrin e Taksës) për njerëzit e porsaardhur është nepërmjet internetit. **Regjistrimi në Internet i TFN** mund të bëhet gjatë 24 orëve të ditës, 7 ditët e javës. Të vetmet gjëra që nevojiten janë të dhënat e pasaportës si dhe adresa e juaj në Australi. Pas afërsisht 10 ditësh TFN (Numrin i Taksës) mund ta prisni në kutinë postare. Ju duhet të ruani TFN tuaj dhe të mos e vendosni aty ku mund të vidhet si p.sh. në portofolin tuaj, çantë apo në celular.

Formularët e Aplikimit gjenden në [zyret e Centrelink](#)--ut, përndryshe mund të printohen nga faqja e internetit të ATO (Zyrës Australiane të Taksave), ose duke i kërkuar me telefon në

TFN Helpline (Linjen Telefonike për Ndhmë me Numrin e Taksës). Koha e pritjes për shqyrtimin e aplikimit dhe dërgimin e TFN është 28 ditë.

Kur filloni punë, punëdhënësi juaj do t'ju kërkojë të plotësoni një formular për TFN Declaration (Deklarimin e TFN-së) në të cilin ju duhet të shkruani TFN-në tuaj. Nëse ju e keni TFN-në që më përpara, punëdhënësi nuk ka të drejtë të nxjerrë më tepër se shumën normale të taksës derisa të ketë kaluar koha e zakonshme, standarte, për shqyrtimin e një kërkesë për TFN-në.

Nëse keni çfarëdo të ardhura gjatë vitit financiar (ndërmjet 1 Korrik dhe 30 Qershor), ju duhet të dorëzoni një **Income Tax Return** (Kthim Takse mbi të Ardhurat) deri në 30 Tetor të atij viti nëse nuk është kryer ndonjë marrëveshje tjetër. Si banor duhet t'i nënshtroheni ligjit Australian dhe në përgjithësi kur të plotësoni taksën tuaj ju kërkohet të paraqisni të gjitha të ardhurat e marra nga brenda ose jashtë Australisë.

Australia ka **Goods and Services Tax (GST)** (Taksën e të Mirave dhe Shërbimeve) që është një taksë prej 10 për qind të çmimit fillestar për mbi shumicën e tyre artikujve. GST përfshihet në çmimin që ju kërkohet të paguani. Disa sende si ushqimi bazë, pjesa më e madhe e shërbimit të arsimit, shërbimet mjekësore, kujdesi për fëmijët për ata që plotësojnë kushtet për shfrytëzim dhe shërbimet e shtëpive të shëndetit për pleq, nuk kanë GST.

Nëse keni biznes atëherë ju keni nevojë për një Australian Business Number (Numrin Australian të Biznesit) për marrëdhëniet me **Australian Taxation Office** (Zyrën Australiane të Taksave) si dhe biznese të tjera. Për më shumë informacion kontaktoni Zyrën Australiane të Taksave:

Të dhënat e kontaktimit të Australian Taxation Office (ATO)

| | |
|---|--|
| Tax File Number Helpline (Linja e Ndhmës për Numrin e Taksës) | 13 2861 |
| Business and GST enquiries (Pyetje mbi Biznesin dhe mbi GST) | 13 2866 |
| Personal Tax Information Line (Linja Informative për Taksën Personale) | 13 2861 |
| Faqja e internetit e Tax Office (Zyrës së Taksave) | www.ato.gov.au |
| TFN online registration | www.ato.gov.au/individuals |

Pasuritë, investimet dhe të ardhurat jashtë shtetit

Banorët Australianë taksohen mbi të ardhurat e tyre në mbarë botën dhe duhet të deklarojnë të gjithë të ardhurat e huaja në income tax return të tyre. Fakti që a jeni apo nuk jeni banor i Australisë për qëllime takse do të vendoset mb bazat e çdo rasti të veçantë. Australian Taxation Office (ATO) ka informacion në faqen e saj të internetit që do t'ju ndihmojë të kuptoni detyrimet tuaja takso.

ATO mund të japin informacion mbi trajtimin e të ardhurave të tilla si:

- Nga investimet e tilla si obligacionet shtetërore dhe shtëpitë me qera
- Interesi dhe të drejtat e autorit
- Bizneset jashtë shtetit
- Marrja e një pensioni nga jashtë shtetit.

Nëse keni të ardhura të taksueshme nga jashtë shtetit, ju duhet ta deklaroni atë edhe nëqoftëse taksa është marrë në vendin ku janë fituar të ardhurat. Nëse e ardhura e huaj është e taksueshme në Australi dhe ju keni paguar taksë të huaj mbi të, ju mund të keni të drejtë për kredit (zbritje) për taksën e huaj. Taksat për të cilat lejohet krediti (zbritja) quhen taksa të zbritëshme.

Ju duhet të deklaroni të ardhurat e huaja që përjashtohen nga taksa Australiane. Kjo e ardhur e huaj mund të merret parasysh kur llogaritet sasia e taksës që ju keni borxh mbi të ardhurat net të tatueshme si nga burimet Australiane dhe të huaja.

Nëse çështjet tuaja financiare janë të komplikuar mund t'ju duhet të angazhoni një agjent taksash ose të kërkoni këshillë nga Australian Taxation Office.

ATO International Tax Essentials

[www.ato.gov.au/individuals/
pathway.asp?pc=001/002/012](http://www.ato.gov.au/individuals/pathway.asp?pc=001/002/012)

8. Sigurimi social

Qeveria Australiane kontribon në rezultatet shoqërore dhe ekonomike duke shpërndarë shërbime për të ndihmuar njerëzit të fitojnë besim në vetvete dhe të mbështesin ato që kanë nevojë. Sigurimi social jepet kryesisht përmes një agjencie qeveritare të quajtur **Centrelink**. **Family Assistance Office** (Zyra e Ndihmës për Familjet) jep asistencë për familjet.

[Vendndodhjet zyra të Centrelink](#) dhe [Vendndodhjet e Zyrave të Family Assistance](#) mund t'i gjeni në numërorin tuaj telefonik lokal White Pages.

Pagesat e Centrelink

Mundësia e marrjes së pagesave si mbështetje me të ardhurat varet nga klasi i vizës suaj dhe nga rrethanat tuaja të veçanta, duke përfshirë të ardhurat dhe pasuritë tuaja. Edhe nëse jeni bërë banor/e i.e. përhershëm/me i.e. Australisë, një periudhë pritjeje për pagesat mund të aplikohet (shikoni më poshtë)

Nëse nuk flisni Anglisht, Centrelink mund të ju sigurojë përkthyes për takimin tuaj. Ju mund të kontaktoni Centrelink në gjuhën tuaj me anë të telefonit:

Centrelink (multilingual services)

13 1202

Centrelink website

www.centrelink.gov.au

Ju duhet t'i tregoni Centrelink-ut dokumenta identifikuese si pasaporta dhe dokumentat e udhëtimit, të dhënat rreth strehimit dhe numrit të llogarisë suaj bankare gjithashtu, kur të aplikoni për pagesa. Më shumë informacione mbi kërkesat e identifikimit gjenden në numrin e mësipërm ose duke transferuar nga interneti në kompjuterin tuaj faqen e fakteve: [Proving your identity to Centrelink](#) (Vertetimin i identitetit tuaj tek Centrelink) nga faqja e internetit e Centrelink-ut.

Ju duhet të keni një Tax File Number (TFN) (Numër Takse) që të keni mundësi të merrni çfarëdo pagese si ndihmë me të ardhurat. Centrelink-u mund t'ju japin një formular lutjeje për TFN dhe ju mund ta dorëzoni pranë Zyrës Australiane të Taksave pasi ta keni plotësuar.

Periudhat e pritjes

Në përgjithësi migrantëve të sapoardhur ju nevojitet të jetojnë në Australi për dy vjet si banorë të përhershëm para se të marrin shumicën e pagesave të sigurimit social, duke përfshirë edhe ndihmat e papunësisë, të sëmundjes, të studentëve dhe një numër pagesash të tjera. Vetëm periudhat e kaluara në Australi si banor/e i.e. përhershëm/e merren parasysh në periudhën e pritjes. Që të keni të drejtën e pensioneve të moshës dhe paaftësisë zakonisht duhet që të keni jetuar në Australi 10 vjet.

Perjashtime nga periudha e pritjes

Refugjatët dhe ata që vijnë në Australi me viza humanitare përjashtohen nga periudha dy vjeçare e pritjes, së bashku me bashkëshortët dhe fëmijët e tyre, nëse këto marrëdhënie (martesa apo bashkëjetesa) kanë ekzistuar para se personat e këtyre dy kategorive (refugjatë dhe me vizë humanitare) të arrinin në Australi.

Në mënyrë të ngjashme, partnerët dhe fëmijët në varësi të qytetarëve Australianë dhe njerëzve që kanë qënë banorë të përhershëm për të paktën dy vjet përjashtohen nga periudha e pritjes. Mund të aplikohen edhe përjashtime të tjera.

Shumica e pagesave janë të vlefshme vetëm për njerëzit që jetojnë në Australi dhe kanë leje të qëndrojnë përgjithmonë. Një pagesë e quajtur **Special Benefit** (Ndihmë Speciale) mund të jepet gjatë periudhës së pritjes, nëse ju jeni në vështirësi për arsye të një ndryshimi tërësor e përtej kontrollit tuaj në rrethanat tuaja. Kjo pagesë jepet vetëm në raste shumë të

rralla. Pamundësia për të gjetur punë apo mbarimi i parave nuk janë arsye të mjaftueshme për kualifikim për Ndihma Speciale. Nëse ju keni emigruar me një Assurance of Support (kur një person në Australi garanton se do të përgjigjet për të gjitha nevojat tuaja duke përfshirë edhe ato financiare), assesor (siguruesi) juaj do të jetë përgjegjës për pagesën e shumës që ju është paguar.

Nëse ju kujdeseni për një person që është banor i përhershëm ju mund të keni të drejtë për **Carer Payment** (Pagesa për personat që kujdesen për anëtarët e Sëmurë/Paaftë të familjes) për të cilën nuk ka periudhe pritjeje dhe nëse ju jeni duke dhënë kujdes të vazhdueshëm mund të jeni i ligjshëm për Carer Payment gjatë periudhës së pritjes.

Nëse ju mbeteni ëie ve, sakat apo prind i vetëm pasi bëheni banor Australian, ju mund të keni të drejtë të merrni pension. Ju gjithashtu mund të merrni pension të moshuari pa patur nevojë që të qëndroni 10 vjet në Australi nëse jeni i mbuluar nga një marrëveshje internacionale e sigurimit social. Nga Janari 2009, Australia ka marrëveshje sigurimi social me 22 vende.

Crisis Payment (Pagesa në rast krize) për personat e hyrë për arsye humanitare

Nga 1 Janari 2008, e drejta për Crisis Payment ishte shtrirë për personat që erdhën në Australi për arsye humanitare për herë të parë me 1 Janar 2008 ose pas kësaj date dhe që mbajnë njërën nga vizat e mëposhtme:

- subclass (nënklasa) 200 – Refugjat
- subclass 201 – Brenda vendit Arsye Humanitare Speciale
- subclass 202 – Arsye Humanitare Speciale globale
- subclass 203 – Shpëtim në rast Urgjence, dhe
- subclass 204 – Grua në Rrezik

Në mënyrë që të kualifikohet për pagesën një person duhet të jetë i pranushëm për një pension ose përfitim Centrelink-u, të jetë në vështirësi financiare dhe të jetë në Australi në ditën e aplikimit. Personi **duhet ta kërkojë Brenda 7 ditëve të mbërritjes në Australi** ose të kontaktojë Centrelink-un me qëllim për ta kërkuar atë brenda 7 ditëve të mbërritjes dhe të dorëzojë kërkesën Brenda 14 ditëve të këtij kontakti.

Crisis Payment për persoant e sapo hyrë për arsye humanitare është pagesë vetëm për një herë që siguron një shtesë në ndihmën financiare për të asistuar me nevojat fillestare të vendosjes së atyre që janë të ligjshëm. Shuma e Crisis Payment është e barabartë me vlerën e pagesës bazë një javore të Centrelink-ut të një personi (duke përjashtuar shtesat si Rent Assistance (Ndihmë me Qeranë) ose Pharmaceutical Allowance (Shtesën Farmaceutike).

Family Assistance payments (Pagesat që ndihmojnë familjet me koston e rritjes së fëmijëve)

Nëse keni fëmijë që varen nga ju, Qeveria Australiane ofron një sërë pagesash nëpërmjet **Family Assistance Office** për të mbështetur familjet me punën dhe përgjegjësitë e tyre familjare. Pagesat kryesore të ndihmës së familjes përfshijnë Family Tax Benefit (Pagesa me drejtë takse për familje), Child Care Benefit (Pagesa për Kujdesje ndaj Fëmijës), Child Care Tax Rebate (Ulja e Taksës për ato që paguajnë pagesë për kopshtet e fëmijëve), Baby Bonus (Pagesa familjes pas lindjes ose adoptimit të një fëmije) dhe Maternity Immunisation Allowance (Pagesa për fëmijët 18-24 muaj që janë plotësisht të Imunizuar).

Në përgjithësi duhet të jeni mbajtës/e i një vize Australine qëndrimi të përhershëm që ta gëzoni këtë të drejtë pagese por mund të ketë edhe disa përjashtime. Nuk ka periudhë pritje për këto pagesa. Është e rëndësishme që të kuptoni që pagesat për ndihmën e familjes kanë

qëllim që të jenë vetëm si një shtesë të ardhurash, dhe nuk mjafton për të jetuar. Pagesat e Ndhmës së Familjes varen nga income test (testimi i të ardhurave tuaja).

Family Assistance Offices (Zyrat e Ndhmës për Familje) janë vendosura në Centrelink, Medicare dhe Zyrat Australiane të Taksimit. Për më shumë informacion mbi pagesat e ndihmës së familjes ose këshillim në lidhje me çfarë mund të keni të drejtë të kërkonti, kontaktoni Family Assistance Office.

Të dhënat e kontaktimit të Family Assistance Office

| | |
|--|--|
| Telephone | 13 6150 |
| Information in languages other than English | 13 1202 |
| TTY (për shurdh/memecat) | 1800 810 586 |
| Family Assistance website | www.familyassist.gov.au |

Moshat e reja

Nëse keni fëmijë mbi moshën 16 vjeçare, ato mund të jenë të ligjshëm për pagesat e sigurimit social si Youth Allowance (Pagesë për të Rinjtë) ose Austudy (pagesë për moshat mbi 25 vjeçare që studiojnë). Për më shumë informacion shkoni tek www.centrelink.gov.au ose thërrisni:

| | |
|---|----------------|
| Youth and Student Services (Shërbimet për të Rinjtë dhe Studentat) | 13 2490 |
| Centrelink Multilingual Call | 13 1202 |

Dikush të merret me Centrelink ose Family Assistance Office për ju

Ju mund të caktoni një person ose organizatë tjetër – që quhet 'nominne' (i nominuar), të veprojë në emrin tuaj në marrëdhëniet me Centrelink dhe ose me Family Assistance Office.

Dikush të merret me entrelink për ju

Ju mund të caktoni një person ose organizatë tjetër – që quhet 'nominne' (i nominuar), të veprojë në emrin tuaj në marrëdhëniet me Centrelink.

Të Drejtat dhe përgjegjësitë

Ka një sërë rregullash dhe kushtesh që ju duhet të plotësoni në mënyrë që të merrni pagesat. Nëse nuk i plotësoni pagasat mund t'ju ndikohen ose edhe të ndalohen.

Centrelink

Nëse merrni një pagesë, ju duhet t'i tregoni Centrelink rreth ndryshimeve në rrethanat tuaja për të bërë të sigurtë që jeni paguar shumën korrekte të pagesës. Kjo përfshinë:

- ndryshimin në të ardhurat tuaja
- ndryshimet në marrëveshjet e jetesës
- nëse martoheni apo ndaheni,
- nëse filloni ose ndaloni studimet
- nëse filloni ose ndaloni punën

Ju gjithashtu duhet t'i lexoni të gjitha letrat që ju dërgon Centrelink dhe t'i përgjigjeni nëse është e nevojshme.

Centrelink i dëgjon klientat e tij dhe kjo e ndihmon Centrelink të përmirësojë Shërbimet e tij. Nëse keni një kompliment, sugjerim apo ankesë, kontaktoni:

Centrelink's Customer Relations Unit(Thirrje falas)

1800 050 004

Në gjuhët jo Anglisht

13 1202

Fshehtësia e informacionit tuaj – Informacioni juaj personal mund të lëshohet nga Centrelink ose Family Assistance Office vetëm ku e lejon ligji ose kur ju jepni lejen.

Family Assistance Office (Zyra E Ndhmës Për Familjet)

Nëse merrni një pagesë, ju duhet të lajmëroni Family Assistance Office për çdo ndryshim në rrethanat e familjes suaj që mund të ndikojë të drejtën tuaj për pagesë. Vizitoni faqen e internetit të Family Assistance për më shumë informacion rreth [të drejtave dhe përgjegjësi](#) [tuaja](#).

Nëpunësit e Shërbimit Shumëkulturore Centrelink

Nëpunësit e Shërbimit Shumëkulturore (MSO-të) janë hallka lidhëse e Centrelink me komunitetet e emigrantëve dhe refugjatëve. Ato japin informacion mbi programet dhe shërbimet për klientat dhe komunitetet dhe konsultojnë gjërisht për të ndihmuar Centrelink që të përmirësojë shërbimet e tij.

Më shumë informacion

Centrelink

Centrelink-u ka shumë informacion lidhur me shërbimet dhe pagesat e tij. Për të sapoardhurit dhe për ata që nuk e kanë Gjuhën Anglisht si gjuhë parësore, ekziston një sasi e madhe informacioni e përkthyer duke përfshirë edhe materialin udhëzues të përgjithshëm, 'Welcome to Centrelink'. Telefononi në 13 1202 për një kopje të saj apo të informacioneve të tjera të përkthyer ose vizitoni faqen internetore www.centrelink.gov.au dhe zgjidhni "[We speak your language](#)" (Ne flasim gjuhën tuaj) në faqen e Centrelink-ut. Mund të gjeni informacion të mëtejshëm mbi pagesat dhe shërbimet e Centrelink-ut duke klikuar në 'individuals' (individët) në faqen kryesore të internetit të Centrelink dhe duke zgjedhur opsionin '[Moved to Australia](#)' (Të vendosur në Australi) të faqes së internetit të Centrelink të nën '[individuals](#)' (individët). Ju mund të merrni informacione të tjera duke telefonuar numrat vijues:

| | |
|---|----------------|
| Centrelink multilingual (Ndhma Shumëgjuhëshe në gjuhët e tjera jo Angleze) | 13 1202 |
| Appointments and opening hours (Takimet dhe orari i punës) | 13 1021 |
| Employment Services, Newstart, Special Benefit (Shërbimet e Punësimit, Newstart, Përfitimi Special) | 13 2850 |
| Age Pensions (Pensionet e Moshës) dhe Pensioner | |
| Concession Cards (Kartat e koncensionit të pensionistave) | 13 2300 |
| Parent or guardian (Prind ose kujdestar) | 13 6150 |
| Youth Allowance and Student Services (Shërbimet për studentët) | 13 2490 |
| Disability (paafësitë), Sickness (sëmundjet) dhe Carers (ato që kujdesen për këto njerëz të sëmurë) | 13 2717 |

| | |
|--|-----------------------|
| Centrelink International Services (Shërbimet Ndërkombëtare të Centrelink) | |
| (pensionet jashtë shtetit) | 13 1673 |
| New Apprenticeship Line | 13 3633 |
| Customer feedback (Përshtypjet e Klientëve) | 1800 050 004 |
| Centrelink TTY (për shurdh memecat) | 1800 810 586 |
| Customer feedback TTY | 1800 000 567 |
| Nëse merrni nga jashtë shtetit | +613 6222 3455 |

Family Assistance Office (Zyra E Ndhmës Për Familjet)

Family Assistance Office ofron gjithashtu informacion rreth shërbimeve dhe pagesave të tij. Për emigrantët e sapoardhur dhe për cilindo që gjuha kryesore nuk është Anglishtja, gjendet një sërë informacionesh të përkthyer rreth ndihmës për familjet. Për të marrë një kopje të Fact Sheet (Letrave me Informacion) të përkthyer rreth pagesës së Family Assistance, thërrisni **13 1202** ose vizitoni faqen e internetit Family Assist dhe zgjidhni [Multilingual Services](#) (Shërbimet në shumë Gjuhë).

9. Transporti

Transporti Publik

Në NSW ka një sërë shërbimesh pasagjerë: me autobus, tren dhe taksi për pasagjerë. Trena të shinave të lehtë dhe trena njëbinarësh gjithashtu funksionojnë në Sydney Central Business District (Pjeswën Qëndrore Biznesore të Sidneit). Ka disa mënyra të ndryshme për të siguruar informacion mbi orarin, biletat dhe rrugët që ndiqen nga mjetet e transportit për shërbimet e transportit për publikun.

Transport infoline

Për akses të shpejtë dhe të volitshëm mbi oraret, planifikimin e udhëtimeve, biletat, të dhënat mbi ngjarjet madhore dhe hartat rrugore për **TE GJITHA** shërbimet hekurudhore, me autobus apo traget në Rajonin e Zgjeruar të **Sydney**-it që përfshin Newcastle-in, Gjirin Qendror, Bathurst-in, Gouldburn-in, dhe Illawarra-n, kontaktoni:

| | |
|--|--|
| Transport Infoline (informacioni si p. sh. ndërprerjet e Shërbimit është i vlefshëm gjatë 24 orëve) | 13 1500 (ndërmjet 6 paradite dhe 10 të darkës çdo ditë) |
| TTY (për shurdh/memecat) | 1800 637 500 (ndërmjet 6 paradite dhe 10 të darkës çdo ditë) |
| Transport website | www.131500.com.au |

Oraret

Pamfletat e orareve të autobuzave privat shpeshherë mund t'ja kërkonti shoferit, ose mund ta telefononi kompaninë e autobuzave. Kompanitë e autobuzave gjenden në numërorin telefonik [Yellow Pages](#) nën titullin 'Bus and coach scheduled services'. Oraret e trenave, autobuzave dhe tragetave janë të shënuara në faqen e internetit www.131500.com.au (Klikoni në Lidhje të Dobishme). Në disa raste, oraret për shërbimet locale mund të jenë të vlefshme nga gazetashitësit.

Në se nuk keni mundësinë e shfrytëzimit të internetit por kërkonti informacion të shtypur në formë pamfleti, për shërbime brenda Rajonit të Zgjeruar të Sidneit, pamfletat mbi oraret e CityRail-it gjenden në çdo zyrë të biletave të CityRail për të gjitha linjat që mbulon. Autobuzat e qeverisë të Sidneit dhe të Neëcastle-it si dhe pamfletat e orareve të Sydney Ferries (Tragetat e Sidneit), gjenden nepër kioskat 'State Transit Sydney Buses Information', nga agjensitë e biletave ose nga qëndrimet e autobuzit: Sydney Buses Ticket si dhe nga agjensitë e zgjedhura që njihen me emrin 'Neëagency' në pjesën qëndrore të Sidneit. Oraret e tragetave të kompanive private mund të sigurohen duke telefonuar kompaninë. Tragetat privatë janë të regjistruar në numërorin telefonik [Yellow Pages](#) (Fletët e Verdha) nën 'Ferries' (Tragetet).

Kontrolloni Stacionin E Autobuzit Ose Platformën E Treni

Shumë stacione të autobuzave dhe platformat e trenave kanë tabela informative rreth orareve të trenave dhe autobuzave lokale.

Për Shërbime Jashtë rajoneve të qyteteve të Sidneit, Newcastle dhe Wollongong-ut

Megjithëse informacioni mbi transportin rajonal nuk është akoma i vlefshëm në telefon, faqja e internetit për informacion Infoline (199Hwww.131500.com.au/countrytransport/), ka informacion mbi udhëtimin me autobuza, autobuzat që udhëtojnë ndërmjet qyteteve, trenin dhe udhëtimin ajror në zonat e fshatrave.

Gjithashtu shoferit të autobuzit mund t'i kërkonit oraret e kompanive private të autobusave, ose mund t'i siguronit duke telefonuar kompaninë. Oraret e udhëtimeve të traqetëve të kompanive private si dhe informacion rreth pajisjes së biletave gjenden duke telefonuar kompaninë. Për informacion mbi "Countrylink" (transporti për në zonat e fshatrave) kontaktoni:

| | |
|--|--|
| Countrylink (oraret the rezervimet) | 13 2232 |
| TTY (për shurdh/ memecat) | 1800 637 500 |
| Website | www.countrylink.info |

Informacione Të Tjera

Informacione të tjera me vlerë dhe të dhëna informative për siguruesit e transportit publik mund të gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Transportit www.transport.nsw.gov.au

Shërbimet e Taksive

Taksitë punojnë 24 orë në ditë në pjesën më të madhe të Australisë. Tarifa tregohet nga një sahat në treguesin e taksisë. Kompanitë e taksive janë shënuar në numërorin telefonik [Yellow Pages](#) nën emrin 'Taxi cabs'. Në shumicën e qyteteve gjenden taksi të veçantë për njerëzit që përdorin karrocë për invalidë. Për taksi të madh ku mund të futet edhe karroca e invalidit, telefononi:

Për taksitë që kanë lehtësi për karrocën e invalidëve në Sidnei, telefononi:

| | |
|---------------|--------------------------------------|
| Sydney | 02 8332 0200 ose 1800 043 187 |
|---------------|--------------------------------------|

Automjetet private

Automjetet e reja dhe ato të përdorura reklamohen për shitje në gazeta dhe gjenden edhe në ekspozita për makina të reja apo vendet e shitjes së makinave të dorës së dytë. Çmimi i blerjes së një automjeti zakonisht nuk përfshin koston e regjistrimit, pullin e taksës dhe siguracionin e detyrueshëm. Zakonisht këto që sapo përmendem duhen paguar veçmas nga blerësi.

Për më shumë informacion rreth regjistrimit të një automjeti në NSW , kontaktoni:

| | |
|--|----------------|
| Roads and Traffic Authority (RTA) (kërkesat e përgjithëshme) | 13 2213 |
|--|----------------|

| | |
|--------------------|--|
| RTA website | www.rta.nsw.gov.au |
|--------------------|--|

Për të parë nëse ish-pronari ka borxhe për një makinë, e cila është regjistruar në cilindo shtet apo territor, përveç Western Australia dhe Tasmani, kontaktoni:

| | |
|--|--|
| Registrar of Encumbered Vehicles (REVS) | www.revs.nsw.gov.au |
|--|--|

| | |
|--|----------------|
| NSW Office of Fair Trading (zgjedhni REVS nga pikat e përmbajtjes) | 13 3220 |
|--|----------------|

REVS mund t'ju tregojë gjithashtu edhe nëse makina është e raportuar në polici si e vjedhur, e paregjistruar për arsye të mos pagesës së gjobave të trafikut ose e shënuar me RTA-në si makinë jashtë përdorimit ose si e regjistruar me Komisionerin e Fair Trading si makinë që mund të ketë ndërhyrje të mundshme në kilometrazh. Për më shumë informacion mbi blerjen e një makine, lexoni publikimin e Zyrës së Tregtisë së Barabartë të quajtur [Car Buyers Handbook](#) (Libri i Blerësve të makinave).

Për informacion lidhur me marrjen e parave hua për blerjen e një automjeti, kontaktoni bankën tuaj apo kompaninë e financave. **Mbani mend të siguroheni që i kuptoni të gjitha kushtet para se të nënshkruani ndonjë kontratë për huamarrje.**

Çdo shtet dhe territor ka shoqatat a motorristëve, të cilat japin shërbime të tilla si inspektime për makina për blerësit potencial të automjeteve të dorës së dytë, informacion për udhëtimet, siguracion dhe shërbim në rrugë (në rast se automjeti juaj priset). Shumica e shërbimeve të tyre jepen për ata që nuk janë anëtarë si edhe për anëtarët, ndërsa shërbimet për anëtarët i mbulojnë ato edhe në Shtete dhe Territore të tjera nëpërmjet organizatave simotra.

Në NSW, ju mund të kontaktoni:

National Road Motorists' Association (NRMA)

13 2132

NRMA website

www.nrma.com.au

Ju duhet të keni një leje për drejtim automjeti (patentë) të vlefshme në menyrë që të drejtoni një automjet në Australi. Për informacion lidhur me marrjen e **driver's licence** (patentës së shoferit) shihni Kapitullin 1, What to do soon after arrival (Ç'duhet bërë shpejtë pas mbërritjes).

Ju lutemi vini re: Ligjet Australiane të trafikut janë shumë strikte. Shihni Kapitullin 5, *Australian customs and laws* (zakonet dhe ligjet Australiane).

10. Arsimi dhe çerdhet

Çerdhet

Ka shumë lloje çerdhesh me orar të plotë dhe të reduktuar për fëmijë që janë shumë të vegjël për të shkuar në shkollë ose për kohën pas shkollës. Numërori telefonik [Yellow Pages](#) ka një sërë zgjedhjesh për llojet e çerdheve që ekzistojnë, duke përfshirë **preschools** (parashkollën) ose **kindergartens** (kopshtet) që i përgatisin fëmijët për në shkollë, **child care** ose **day care** (qendrat për kujdesin gjatë ditës) që kujdesen për fëmijë më të vegjël dhe **family day care** (qendrat familjare) ku një prind kujdeset për fëmijët së bashku me familjen e tij/saj.

Ka edhe **playgroups** (grupe loje), ku prindërit e fëmijët mblidhen së bashku që fëmijët të mësojnë dhe qëndrojnë së bashku si dhe që prindërit të flasin e të shkëmbejnë informacione, etj.

[Playgroup NSW Inc](#)

(02) 9604 5513 or 1800 171 882

Mund të jeni të ligjshëm për kopësht/çerdhe falas për fëmijët nën moshën shkollore, kur ju shkoni në klasat e **Adult Migrant English Program** (AMEP). Nëse ju përparoni në një program të ndryshëm studimi pasi keni mbaruar orët që ju takojnë nga AMEP-i është e rëndësishme që të rishikoni marrëveshjen për pagesën për çerdhëkopësht pasi programet e tjera nuk i mbulojnë këto shpenzime.

Për informacionin e dhënë nga qeveria lidhur me:

- shërbimet e kujdesit të fëmijëve në zonën tuaj
- llojet e kujdesit për fëmijë dhe vendet lirshme të mundëshme
- ndihmën e qeverisë për shpenzimet e kujdesit
- shërbimet për fëmijë me nevoja të veçanta
- shërbimet për fëmijë me prejardhje të ndryshme kulturore

kontaktoni shërbimin informativ të **Child Care Access**.

Child Care Access Hotline

(8 paradite – 9 të darkës, të Hënën deri të Premten)

1800 670 305

TTY (për shurdh/memecat)

1800 639 327

Vini re se ju mund të keni të drejtë të merrni Child Care Benefit (Përfitim për ÇerdhëKopshte) dhe pagesa për Family Assistance (Ndihmë Familjare) si ndihmë për çerdhet/kopshtet e shpenzime të tjera. (Shihni Kapitullin 8, *Social Security* (Sigurimi social))

Shkollat

Parashkollat janë të vlefshme për të gjithë fëmijët 4 vjeçarë. Parashkollat ndihmojnë fëmijët që të zhvillohen fizikisht, emocionalisht dhe në shoqërisht në vitin para se të shkojnë në shkollë.

Është e detyrueshme që fëmijët e moshës mes 6 dhe 15 vjeç të shkojnë në shkollë. Fëmijët zakonisht e fillojnë shkollën kur janë 4 ose 5 vjeç dhe vazhdojnë derisa ato bëhen 17 ose 18 vjeç, si përgatitje për universitetet ose arsimim të mëtejshëm. Fëmijët nën 12 ose 13 vjeç ndjekin **primary school** (shkollën fillore) dhe ata më të mëdhenj shkojnë në **high school** (shkollën e mesme). Disa **colleges** (kolegje) (shkollat të mesme për moshë më të rritura) marrin vetëm nxënës të moshës së rritur që në përgjithësi janë duke u përgatitur për provimet finale.

Ju mund t'i dërgoni fëmijët tuaj ose në një shkollë publike ose në një private. Për të gjetur shkollat e zonës suaj mund të shihni nën 'Schools' në numërorin telefonik [White Pages](#) ose vizitoni faqen e internetit www.education.gov.au.

Government Schools (Shkollat Shtetore) japin arsim falas, megjithatë, në shumicën e shkollave kërkohen kontribute vullnetare për të ngritur nivelin e programeve mësimore dhe sportive të shkollës. Paga është një çështje që prindërit të vendosin nëse duan apo jo. Janë disa materiale ose shërbime shtesë që prindërit duhet të sigurojnë ose të paguajnë shkollën për t'i siguruar. Prindërit mund të duhet t'ju sigurojnë fëmijëve lapsa, stilolapsa, libra dhe uniformat e shkollës (ku është e nevojshme).

Shënim: Studentëve që kanë viza të përkohëshme mund t'ju kërkohet që të paguajnë pagesën e plotë të shkollës. Kontrolloni me shkollat e ndyshme për më shumë informacion.

Non-government Schools (Shkollat private) kërkojnë pagesë, dhe ato mund të kenë drejtim fetar ose një filozofi të caktuar arsimore. Prindërit që duan të mësojnë më shumë për shkollat private mund të caktojnë një takim me autoritetin përkates arsimor joqeveritar ose të kontaktojnë direkt shkollën që kanë zgjedhur.

Pyesni në shkollën tuaj rreth **before and after school care** (kujdesje para dhe mbas shkollës) ose **school holiday programs** (programi i pushimeve të shkollës) për fëmijët e moshës shkollore.

Fëmijët që nuk flasin Anglisht

Fëmijët e porsaardhur që nuk flasin anglisht mund të përfitojnë nga programi (ESL) (Anglishtja si Gjuhë e Dytë). Ndërsa studentët të porsaardhur të moshës së shkollës së mesme mund të regjistrohen në një Qendër ose Gjimnaz ku gjuha Angleze mësohet intensivisht. Këto Qendra dhe Gjimnaze ndodhen në zonën e qytetit të Sidneit dhe në Wollongong. Kurse fëmijët e shkollës fillore (deri në klasën e 6-të) përfitojnë nga programi ESL si pjesë e programit të shkollës fillore.

Përkthyesat

Prindërit dhe kujdestarët që nuk flasin ose flasin pak Anglisht t'i kërkojnë shkollës që një përkthyes të jetë prezent kur diskutohen çështje në lidhje me fëmijët e tyre. Për të kontaktuar shkollën ato mund telefonojnë gjithashtu edhe Translating and Interpreting Service (TIS National) (Shërbimin për Përkthime).

Translating and Interpreting Service (TIS National)

13 1450

TIS National website

www.immi.gov.au/tis

Regjistrimi

Që të regjistroni fëmijët tuaj në shkollë, kontaktoni shkollën me telefon ose shkoni vet. Ju duhet të merrni me vete vizën ose dokumentet e Hyrjes në Australi, prova të datës së lindjes së fëmijës tuaj, dhe të gjitha dokumentet letrat etj, duke përfshirë edhe raportet e shkollës që kanë lidhje me arsimin e deritanishme. Mund t'ju duhet t'i paraqisni edhe **dokumenatat e imunizimit** (vaksinimet e fëmijëve).

Në shkollat e shtetit të NSW, shumicës së studentave që mbajnë viza të përkohshme iu kërkohet të paguajnë. Disa kategori vizash përjashtohen nga pagesa dhe kërkesat për përjashtim shqyrtohen një nga një. Për më shumë informacion kontaktoni:

Temporary Visa Holders Unit (Njësia përgjegjëse për personat me viza të përkohëshme)

1300 300 229

Për më shumë informacion në lidhje me shkollat shtetërore në NSW, ju lutemi kontaktoni:

[Department of Education and Training](#)

(02) 9561 8000

(Sporteli i Zyrës Kryesore)

Arsimi Profesional

Kurset e **VET (Vocational Education and Training)** (Arsimim Zanati dhe Treinim) dhe **TAFE (Technical and Further Education)** (Arsimim Teknik dhe i Mëtejshëm) janë formuar për studentë që duan të marrin aftësi profesionale apo zanate. Kurse të shumta mbulojnë një sërë fushash profesionale si teknologji informative, shërbime biznesi, art dhe gazetari, turizëm dhe shërbime, ndërtim dhe transport, prodhim bujqësor dhe miniera dhe inxhinieri. Kolegjet e VET dhe TAFE-it janë me pagesë dhe nxënësit zakonisht duhet t'i blejnë vetë librat. Nxënësit duhet të kenë mbaruar shkollën e mesme që të kualifikohen për pranim në disa nga këto kurse. Për më shumë informacion kontaktoni:

TAFE Information Centre

13 1601

TAFE NSW website

www.tafe.nsw.edu.au

Universitetet

Universitetet Australiane janë ndër më të mirat në botë. Një degë normale e universitetit merr 3 vjet, por ka edhe degë dyshe dhe studime pasuniversitare që zgjasin më shumë për t'u mbaruar. Disa degë kanë mësim me korrespondencë dhe mësim me orar të reduktuar (part-time).

Për informacion lidhur me pranimet dhe degët, kontaktoni universitetin e duhur, ose vizitoni faqen e internetit **going to university** (të shkuarit në universitet).

Faqja e internetit **Study in Australia** (Studioni në Australi) ka informacion të dobishëm rreth të studiuarit në Australi, informacion ky që gjendet në 12 gjuhë

Study in Australia website

studyinaustralia.gov.au

Going to Uni website

www.goingtouni.gov.au

Universities Admission Centre (Qendra e Pranimet në Universitet) (NSW & ACT) Pty Ltd (UAC) shqyrton aplikimet për shumicën e kurseve në universitetet e ndodhura në New South Wales dhe Australian Capital Territory. Qendra tani shqyrton edhe aplikantët pasuniversitarë të disa universiteteve. Për më shumë informacion kontaktoni:

Universities Admission Centre

9752 0200

Website

www.uac.edu.au

Shpenzimet për kurset universitare mund të përfshijnë pagesat për studime, pagesat e rastësishme, librat, koston e banimit koston e përgjithshme të jetesës. Për më shumë informacion mbi ndihmën që mund të jetë e vlefshme për ju shko tek:

**Going to Uni
Student Enquiry Line**

1800 020 108

Pagesat e **Youth Allowance** (për njerëz të moshës 16-24 vjeç) dhe **Austudy** (për ata 25 vjeç e lart) japin ndihmë financiare për studentët me orar të plotë që u është aprovuar studimi. Të dyja pagesat varen nga të ardhurat dhe pronësitë të cilat duhet të jenë brenda një kufiri të caktuar. Për të sapoardhurit zakonisht vlen periudha dy vjeçare e pritjes. Për më shumë informacion lidhur me këto skema mbështetjeje financiare kontaktoni Centrelink-un (shihni Kapitullin 8, *Social Security* (Sigurimi social))

11. Sistemi Shëndetësor

Medicare

Qeveria Australiane siguron ndihmë në lidhje me shpenzimet mjekësore dhe spitalet nëpërmjet një programi që quhet **Medicare**. Medicare paguan për shumicën e kostove të vizitave tek doktorët, radiografitë, analizat e gjakut, kujdesin në spitalet publike, dhe disa shërbime të tjera.

Për të parë nëse mund të regjistroheni në Medicare, duhet të shkoni në zyrën e Medicare me pasaportën tuaj, dokumentet e udhëtimit dhe vizën e përherëshme.

Medicare **nuk paguan** për shpenzimet e autoambulancave, dentistët, fizioterapitë, optikat, sëmundjet e këmbëve, kiropraktikat, ose për spitalet private. Për më shumë informacion për Medicare, shihni Kapitullin 1, What to do soon after arrival (Ç'duhet bërë shpejtë pas mbërritjes).

Medicare website

www.medicareaustralia.gov.au

Centrelink Health Care Card (Karta e Kujdesit për Shëndetin e Centrelink)

Nëse ju merrni një pagesë **Centrelink**-u ose fitoni të ardhura të ulëta, ju mund t'ju takojë me ligj një [Health Care Card](#) nga Qeveria (Karta e Kujdesit për Shëndetin). Karta do t'ju japë të drejtën për një sërë lëshimesh, duke përfshirë koston e ilaçeve dhe shërbimeve mjekësore (mjek, dentist dhe ambulancë). Për më shumë informacion mbi Centrelink, shikoni Kapitullin 8, *Social security*.

Edhe pse keni Health Care Card, ju duhet të paraqitni Medicare card për të gjithë trajtimet themelore spitalore dhe mjekësore në lidhje me Health Care Card.

Sigurimi Shëndetësor Privat

Shumë Australianë zgjedhin të paguajnë sigurim shëndetësor privat. Këto mbulojnë të gjitha ose një pjesë të kostos së trajtimit si pacient privat në spitalet publike dhe ato private, dhe mund të përfshijnë disa shërbime që nuk mbulojnë nga Medicare, si shërbimet e kujdesit dentar, shumicën e shërbimeve të kujdesit optik dhe transportin e ambulancës. Shpenzimet dhe llojet e sigurimit ndryshojnë shumë prandaj është me rëndësi që të krahasoni fonde të ndryshme **kontrolloni të dhënat me kujdes para se të pranoni llojin e sigurimit, kur vendosni të bleni sigurimin shëndetësor privat.**

Iniciativat

Qeveria ofron një sërë nismash financiare për të inkurajuar njerëzit që të marrin sigurim shëndetësor privat. Nëse mendoni të merrni Sigurimin Shëndetësor Privat ju duhet të jeni në dijeni të:

1. **The 30 per cent Rebate** (Zbritja 30 për qind) – të gjithë Australianët janë të ligjshëm të kërkojnë 30 për qind zbritje nëse janë të ligjshëm për Medicare dhe kanë një sigurim shëndeti që përmbush kushtet dhe që siguron trajtim spitalor, trajtim të përgjithshëm ('ndihmëse' ose 'ekstras') ose të dyja. (Për njerëzit e moshës 65-69 vjeç Zbritja është 35 për qind, dhe për njerëzit e moshës 70 vjeç e sipër Zbritja është 40 për qind).
2. **The Medicare Levy Surcharge** (Mbledhja e Mbitaksës për Medicare) – Shumica e takspaguesave Australianë kanë një Medicare Levy të përfshirë në sasinë e taksës që ato paguajnë. Medicare Levy Surcharge është një 1 për qind mbipagesë shtesë e ushtruar mbi njerëzit që fitojnë më shumë se një sasi e

caktuar dhe nuk kanë siguracion spitalor. Sasitë e caktuara të të ardhurave janë momentalisht 70,000 dollarë Australinë në vit për beqarët dhe 140,000 dollarë Australianë në vit për çiftet ose familjet.

- 3. Lifetime Health Cover** (Siguracioni Shëndetësor për jetë) – kjo skemë inkurajon njerëzit për të marrë siguracion hospitalor që në moshë të re. Nëse një person merr siguracion hospitalor pas 1 Korrikut të parë pas 31 vjetorit të tyre, ato do të paguajnë më shumë për të njëjtin nivel siguracioni se një person që e ka marrë atë para 1 Korrikut të parë pas 31 vjetorit të tyre. Kostoja rritet nga 2 për qind për çdo vit që ai person vonon marrjen e siguracionit.

Kushte të veçanta zbatohen për emigrantët e rinj që arrijnë në Australi pas 1 Korrikut të parë pas 31 vjetorit të tyre. Emigrantët nuk paguajnë më shumë nëse blejnë siguracion privat për spital brenda 12 muajve nga dita e regjistrimit me Medicare.

Është e rëndësishme të konsideroni marrjen e siguracionit për spital vitin e pare pasi të jeni të regjistruar për Medicare. Nëse ju vendosni të prisni më shumë se 12 muaj pasi jeni regjistruar për Medicare, atëherë do t'ju duhet të paguani një shtesë 2 për qind për çdo vit që ju jeni mbi moshën 30 vjeç kur të vendosni të merrni siguracion për spital.

Më shumë informacion

Ju mund të merrni më shumë informacion për sigurim shëndetësor privat duke vizituar faqet e internetit www.privatehealth.gov.au dhe www.phiac.gov.au ose duke kontaktuar:

Private Health Insurance Ombudsman

1800 640 695

Private Health Insurance Ombudsman website

www.phio.org.au

Ndihma Mjekësore

Emergencies (Urgjencat)

Trajtim **Urgjent** mund të merret përmes disa qendrave mjekësore ose departamenteve të urgjencës së spitaleve. Spitalet publike dhe private ndodhen të shënuar nën 'Hospitals' në numërorin telefonik të [White Pages](#). Informacioni për ambulancat jepet në Kapitullin 3, *Emergency services* (Shërbimet e urgjencës).

Kur shkoni në spital mos harroni të merrni me vete ilaçet që përdorni si dhe kartën 'Medicare', kartën e anëtarësisë së sigurimit shëndetësor privat, Kartën e Përfitimeve Shëndetsore apo Kartën sipas Pensioneve të ndryshme.

Mjekimi për urgjenca është i vlefshëm 24 orë në repartet e 'Casualty' (Aksidenteve) ose 'Emergency' (Urgjencës) të spitaleve publike.

Nëse një situatë nuk është urgjente ju duhet të kërkonti ndihmë mjekësore nga një general practitioner (mjek i përgjithshëm)

General Practitioners (GPs) (Mjekët e përgjithshëm)

Nëse nuk është rast urgjent, ju duhet të shkoni në fillim tek doktori i familjes (i quajtur edhe 'general practitioner' ose GP) ose në një qendër mjekësore. Ju mund ta zgjidhni vetë doktorin ose qendrën mjekësore që do shkoni - ato janë të rreshtuar në numërorin telefonik [Yellow Pages](#) nën emrin 'Medical Practitioners'.

Doktori juaj mund t'ju faturojë sipas sistemit **bulk bill**. Kjo do të thotë se ju duhet të nënshkruani një formular të Medicare, dhe doktori këtë formular e dërgon në Medicare, e cila më pas e paguan doktorin. Ndryshe doktori mund të marrë pagesën nga ju, dhe ju mund të kërkonti që të merrni paratë mbrapa nga Medicare ose nga sigurimi shëndetësor privat (nëse keni të drejtë). Në të dy rastet, ju duhet të keni me vete kartën e Medicare (dhe kartën e Health Care nëse e keni).

Përkthimi

Mjekët mund të kenë një linjë telefoni që ka përparësi për të thirrur një përkthyes për të përkthyer për ju gjatë kohës së konsultës suaj mjekësore. Kjo nuk kushton as për ju as për mjekun, duke patur parasysh që ju jeni banor i përhershëm ose nënshtetas Australian dhe gjithashtu edhe kur konsultimi juaj mjekësor është i mbuluar nga Medicare. Edhe një mjek i përgjithshëm mund të rezervojë një përkthyes që të jetë prezent nëse është e nevojshme.

TIS National Doctors Priority Line (24 orë) **1300 131 450**
(Linja e telefonit e Mjekëve që ka Përparësi e TIS National-it 24 orëshe)

TIS National website www.immi.gov.au/tis

Specialists (Specialistat)

Ju nuk mund të bëni vizitë tek një specialist pa shikuar përpara një GP (mjek të përgjithshëm). Doktorit mund t'ju rekomandojë tek një ose specialistë mjekësor të tjerë për mjekim të mëtejshëm.

Medicines (Ilaçet)

Nëse doktori juaj mendon se keni nevojë për ilaçe, mund t'ju jepet një recetë për ta marrë në një **chemist** shop (dyqan kimisti) (ose farmaci). Shumë ilaçe, si antibiotikët, janë të vlefshëm vetëm me recetë. Nëse keni një Health Care Card (Kartë Shëndeti) ose Pensioner Concession Card (Kartë Pensionisti) nga Centrelink ju do të jeni të ligjshëm për konçesion në disa ilaçe. Ju duhet të sillni kartën tuaj të Medicare kur të merrni ilaçet nga farmacia.

Është e rëndësishme t'i lexoni etiketat dhe instruksionet në ilaçe me kujdes dhe të bëni pyetje nëse jeni të paqartë. Për ndihmë ose informacion në lidhje me ilaçet, bisedoni me njërin prej farmacistëve ose telefononi.

Medicines Line **1300 888 763**
(Te hënën deri të Premten, 9 paradite deri 6 pasdite)

Website www.nps.org.au

Qendrat Shëndetësore të Komunitetit

Community Health Centres (Qendrat Shëndetësore të Komunitetit) sigurojnë shërbime me kosto të ulët për njerëz të të gjitha moshave. Jo të gjitha qendrat sigurojnë të njëjtat shërbime. Megjithatë, shpeshherë shërbimet e vlefshme përfshijnë infermierinë, përkrahje dhe edukim për shëndetin, fizioterapi, kujdes dentar, kujdes mjekësor, këshillim dhe mirëqënie sociale. Ato janë të rreshtuara në numërorin telefonik [White Pages](#) nën emrin 'Community Health Centres'.

Shëndeti Mendor

Ekzistojnë një numër shërbimesh për njerëzit që kanë nevojë për ndihmë me problemet e shëndetit mendor dhe me sëmundjet mendore. Në shumicën e rasteve, njerëzit që kanë nevojë për ndihmë për vështirësitë e shëndetit mendor duhet të kontaktojnë mjekun e tyre të përgjithshëm ose Community Health Centre (Qendren Shëndetësore të Komunitetit).

Shërbimet për njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore dhe gjuhësore

Shumica e spitaleve dhe qendrave të mëdha mjekësore kanë grupe profesionistësh mjekësorë që japin shërbime për komunitetet e emigrantëve lokale. Këto shërbime përbëhen nga konsulta, këshilla, rekomandime dhe informacione për shëndetin. Telefonojini spitalit

lokal ose Qendrës Shëndetësore të Komunitetit për të parë nëse kanë **Multicultural Health Worker** (Punonjës Shëndetësor Multikulturor) për grupin e gjuhës suaj.

Siguria e fëmijës dhe parandalimi i aksidenteve

Kidsafe, the Child Accident Prevention Foundation (Fondacioni i Parandalimit të Aksidentit të Fëmisë) i Australisë është një organizatë jo-qeveritare që siguron prindërve dhe komuniteteve informacion dhe shërbime mbi sigurinë e fëmisë dhe parandalimin e aksidenteve. Disa Faqe Faktesh të përkthyer janë të vlefshme në seksionet e faqeve e internetit të Kidsafe të Western Australia dhe Victoria.

Kidsafe NSW

(02) 9845 0890

Help in languages other than English

131 450

Website

www.kidsafe.com.au

Imunizimi (Vaksinimi)

Imunizimi i mbron si fëmijët edhe të rriturit nga infeksionet e dëmshme për shëndetin. Imunizimi nuk është i detyruar por rekomandohet për të gjithë fëmijët. Disa Shtete dhe Territore (NSW, VIC, TAS, dhe ACT-ja) kanë kërkesën e paraqitjes së imunizimit (vaksinimit) të fëmijës kur të futet në çerdhe apo kopësht si dhe para se të regjistrohet në shkollë. Kjo praktikë ndiqet që çerdhja, kopështi apo shkolla të kenë dijeni se cilët fëmijë nuk janë imunizuar. Imunizimet mund të bëhen tek mjeku i juaj familjar ose në Qendrën Shëndetësore të Komunitetit. tuaj.

Nëse dëshironi të imunizoheni në Qendrën Shëndetësore të Komunitetit tuaj ose në këshillin lokal, ju duhet t'i kontaktoni dhe t'i pyesni se cilat vaksina janë të vlefshme dhe kur janë të vlefshme.

Për të marrë Child Care Benefit (Përfitim për Kujdes për Fëmi) fëmija juaj duhet të jetë i vaksinuar ose të jetë i përjashtuar për vaksinim.

Nëse fëmijët tuaj nuk kanë bërë vaksinat, mund të mos ju takojnë me ligj pagesat për kujdesjen e fëmijëve.

National Immunisation Infoline

1800 671 811

[Australian Childhood Immunisation Register](http://www.immunise.health.gov.au)

1800 653 809

National Immunisation website

<http://immunise.health.gov.au>

Shërbimet Stomatologjike

Në zonën tuaj lokale ka dentistë privatë të cilët zakonisht marrin pagesa për shërbimin e tyre. Ju mund të dëshironi që të merrni sigurim shëndetësor privat si ndihmë për pagesat e shërbimit dentar.

Edhe Qeveritë e Shteteve dhe të Territoreve japin një sasi të kufizuar kujdesi dentar falas për mbajtësit e kartave të koncesioneve të Centrelinkut. Shërbimet e dhëna janë për lehtësimet primare të dhimbjeve dhe disa shërbime bazë duke përfshirë edhe protezat. Ju lutemi të kontaktoni qendrën mjekësore më të afërt ose spitalin për hollësitat e shërbimeve në zonën tuaj dhe kontaktoni Centrelink-un (shikoni kapitullin 8, *Social Security*) për të parë nëse kualifikoheni për një koncesion.

Përdorimi i kujdesit për të moshuarit

Kujdesi për të moshuarit është për njerëz të moshuar që nuk mund të jetojnë më në shtëpinë e tyre për arsye të ndryshme si sëmundje, paaftësi, kur humbin të afërmit, në rast urgjence, kujdestari, familja apo shoqëria e tyre e ka të nevojshme një gjë të tillë ose vetëm se është e

vështirë të jetosh në shtëpi pa ndihmë. Ato që kanë më pak nevojë për kujdes se sa ofrohet në azilet e pleqve mund të dëshirojnë të marrin në konsideratë apartamentet e pavarura ose blloqet e shtëpive për pensionistët.

Aged Care Assessment Teams (Grupet e Vlerësimit të Kujdesit për të Moshuarit) (ACATs) ju këshillojnë mbi llojet shërbimeve të financuara nga Qeveria që ju nevojiten ju në mënyrë që të vazhdoni të jetoni në shtëpinë tuaj ose nëse ju duhet të shkoni në një shtëpi pleqsh.

Janë 5 hapa që duhet të ndiqni kur të doni të hyni në një shtëpi pleqsh. Ato janë:

- Vlerësimi i drejtës suaj
- Gjetja e një shtëpie
- Llogaritja e kostos
- Aplikimi
- Hyrja në të dhe rregullimi

Për ndihmë me çështjet e kujdesit për të moshuarit, kontaktoni:

Aged and Community Care InfoLine

1800 500 853

Seniors website

www.seniors.gov.au

Department of Health and Ageing

(Departamenti i Shëndetit dhe të Moshuarëve)

1800 020 103

Qendrat e Commonwealth Carelink japin ndihmë dhe informacion për personat që kujdesen për të moshuarit dhe për njerëzit me paaftësi fizike. Për më shumë informacion kontaktoni:

Commonwealth Carelink Centres

1800 052 222

Carelink Centres website

www.commcarelink.health.gov.au

Më shumë informacion

Për më shumë informacion dhe të dhëna për shërbime të tjera shëndetësore, pyesni doktorin tuaj lokal, qendrën mjekësore, Community Health Centre, spitalin ose farmacistin.

12. Argëtimi dhe Media

Aktivitetet në natyrë

Australia është e përshtatshme për aktivitete në natyrë, si udhëtime, ecje në pyll, kampe dhe sporte. Ka disa rregulla sigurimi për të kujtuar kur jeni jashtë në natyrë:

- Në det gjithmonë notoni në zona që patrollohen nga shpëtimtarët e jetës. Notoni gjithmonë në zonën mes flamujve. Jo të gjithë plazhet patrollohen nga shpëtimtarët e jetës.
- Shmangni të notuarit dhe të peshkuarit vetëm.
- Vini kapele në ditët me diell që të shmangni djegien e lëkurës nga dielli dhe kancerin e lëkurës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për fëmijët dhe shumë shkolla do të insistojnë në veshjen e kapelave të diellit gjatë muajve të verës
- Lyeni lëkurën me krem për mbrojtje nga dielli. Mund ta blini në supermarkatë ose në farmaci.
- Zjarret e hapura dhe skarat e mëdha nuk lejohen në ditët e total fire ban (ndalim i plotë i zjarrit). Për më shumë informacion mbi ditët e ndalimit të plotë të zjarrit kontaktoni:

Weather forecasts (Parashikimi i motit) **1196**

Bureau of Meteorology website www.bom.gov.au/weather/

The Royal Life Saving Society Australia www.royallifesaving.com.au

Swim Australia www.swimaustralia.org.au

Kidsafe www.kidsafe.com.au

Numrat e mëposhtëm të telefonit mund të jenë të dobishëm:

NSW Department of Environment and Climate Change **1300 361 967**

The National Parks and Wildlife Service Website www2.nationalparks.nsw.gov.au/parks.nsf/WebMgmt/HTMLPages+Homepage

Department of Primary Industries **(02) 9527 8411 or 1300 550 474**

Primary Industries website www.dpi.nsw.gov.au/fisheries

Media

Shumica e dyqaneve të gazetave në qendrat e mëdha tregëtare kanë gazeta në një sërë gjuhësh, por nëse ata nuk mbajnë atë lloj që ju dëshironi, ju mund ti kërkonti që ata ta porosisin për ju.

Special Broadcasting Service (SBS) (Shërbimi i Veçantë i Transmetimeve të Emisioneve) stacionet televizive dhe të radios kanë programe në shumë gjuhë të ndryshme të komunitetit. Programet javore janë të shënuara në gazetatat e qytetit.

Lista e stacioneve etnike të radios mund të gjendet në faqen e internetit të **National Ethnic and Multicultural Broadcasters' Council (NEMBC)** (Këshilli i Transmetuesve Etnik dhe Multikulturor Kombëtar).

Disa stacione radiofonike shumëgjuhëshe janë:

| Radio Stacioni | Frekuenca |
|---|--|
| SBS (Sydney) | 1107 KHz (AM) / 97.7 MHz (FM) |
| SBS (Newcastle & the Hunter) | 1413 KHz (AM) |
| SBS (Wollongong) | 1485 KHz (AM) |
| SBS (Young) | 98.7 MHz (FM) |
| 2000 FM (Sydney) | 98.5 MHz (FM) |
| 2BFM/2BCR (Sydney) | 100.9 MHz(FM) |
| 2MFM Muslim Community Radio (Sydney) | 92.1MHz (FM) |

Përpara se të nënshkruajnë kontratat për shërbimet e komunikimit, të gjithë konsumatorët duhet të kontrollojnë që shërbimi që po lidhen ju nevojitet për kushtet e tyre të jetesës. Ne disa raste kanë nënshkruar për abonim për stacione televizive me pagesë duke menduar se ky shërbim ju është dashur për shikimin e stacioneve televizive që janë falas.

Interneti

Gjenden një sërë programesh që ofrojnë shërbimin e internetit dhe trenimit falas ose me një çmim të ulët për ata njerëz që për ndryshe nuk mund të shfrytëzonin internetin. Për më shumë informacion, kontaktoni këshillin tuaj lokal ose shkollën tuaj të lagjes (për ata që jetojnë në zonat rurale dhe të largëta). Bibliotekat publike mund t'ju ofrojnë hyrje falas në internet.

Australian Library Gateway

www.nla.gov.au/libraries

Australian Internet Cafes

www.gnomon.com.au/publications/netaccess/

13. Departamenti i Emigracionit dhe Nënshetësisë

Department of Immigration and Citizenship (DIAC) (Departamenti i Emigracionit dhe Nënshetësisë) është pika juaj kontaktuese për të gjitha çështjet e vizave dhe nënshetësisë Australiane. Shumë informacione të përgjithshme të imigracionit gjenden dhe në faqet e internetit **DIAC Living in Australia** (Jetesa në Australi) duke përfshirë vendosjen në Australi.

DIAC kërkesat **13 1881**

DIAC website www.immi.gov.au

Living in Australia web pages www.immi.gov.au/living-in-australia

Zyrat e zonave të ndryshme të DIAC (Departamentit të Emigracionit dhe Çështjeve Shumë Kulturore) merren me një sërë shërbimesh për imigrim, si viza dhe leje, dhe kërkesa për qëndrim të përkohshëm dhe të përhershëm.

DIAC
Ground Floor
9 Wentworth Street
PARRAMATTA NSW 2150

DIAC
Ground Floor
26 Lee Street
SYDNEY NSW 2000

Nënshetësia Australiane

Hapi i parë për tu bërë nënshetës Australiane për shumicën e banorëve të përhershëm është kalimi i testit të nënshetësisë. Si përgatitje për testin ju duhet të lexoni librin e nënshetësisë që është i vlefshëm në faqen e mëposhtme të internetit.

Pasi të keni kaluar testin dhe të keni plotësuar kërkesat e tjera për nënshetësinë Australiane, duke përfshirë të jetuarit në Australi për një kohë të caktuar dhe karakterit të mirë, ju duhet të bëni një aplikim për nënshetësi Australiane. Nëse aplikimi juaj është i suksesshëm, ju do të ftoheni të merrni pjesë në një ceremoni të organizuar për nënshetësinë. Në këtë ceremoni përpara se të bëhen nënshetës Australiane shumicës së aplikuesave të rritur do tu kërkohet të bëjnë një Betim. Për më shumë informacion duke përfshirë ligjshmërinë dhe formularët e aplikimit shkoni në:

Citizenship Information Line (në Australi) **131880**

Citizenship website www.citizenship.gov.au

Ju mund të aplikoni për nënshetësi Australiane pasi të keni kaluar testin dhe keni plotësuar kërkesat e tjera për nënshetësinë Australiane, duke përfshirë jetesën e Australi për një periudhë kohe të caktuar dhe karakterit të mirë. Nëse aplikimi juaj është me sukses, do të ftoheni të merrni pjesë në ceremoninë e nënshetësisë. Shumica e aplikantëve të rritur në ceremoni kërkohet të Betohe për Përkushtim përpara se të bëhen nënshetës Australiane.

Për qytetarët Australiane është e detyrueshme të regjistrohen për të votuar nëse jeni 18 vjeç e sipër. Ju jepet mundësia të regjistroheni në ceremoninë e marrjes së Nënshetësisë. Ju mund të regjistroheni kur jeni 17 vjeç gjithashtu për të qenë gati për të votuar kur të mbushni 18.

Formularët e regjistrimit janë të vlefshëm nga zyrat e postave, zyrat e **Australian Electoral Commission** (AEC) (Komisioni Australian i Zgjedhjeve) dhe faqen e internetit të AEC. Plotësimi i një formulari do t'ju regjistrojë për zgjedhjet federale, zgjedhjet e shtetit/territorit dhe shumicën e zgjedhjeve të qeverisë lokale. Sa herë që ndërroni adresë duhet të plotësoni një formular të ri regjistrimi. Më shumë informacion është i vlefshëm në faqen e internetit (edhe në gjuhët jo Anglisht) ose thërrisni AEC nëse keni ndonjë pyetje.

Vizat e kthimit për banorët

Nëse ju jeni banor i përhershëm Australian dhe planifikoni të largoheni nga Australia për çfarëdolloj periudhe të përkohshme dhe dëshironi të ktheheni në Australi, ju mund të keni nevojë për një **Resident Return Visa** (Viza e kthimit për banorët). Kontaktoni DIAC-n për të parë nëse keni nevojë për vizë që të ktheheni në Australi.

Vizitat Familjare në Australi

Për vizitë

Vizitorët duhet të bëjnë kërkesë për një vizë që mbulon gjithë kohën e qëndrimit të tyre në Australi. Çdo lloj vize vizitori ka kushte të veçanta, prandaj për më shumë informacion kontaktoni **Australian Overseas Immigration Office** (Zyrën më të afërt të Imigracionit Australian jashtë Shtetit) (shikoni më poshtë).

Sistemin **Electronic Travel Authority (ETA)** (Autoriteti Elektronik i Udhëtimit) mund ta shfrytëzojnë mbajtësit e pasaportave nga më shumë se 30 shtete përmes agjensive të autorizuara të udhëtimit dhe linjave ajrore, dhe përmes shumicës së zyrave diplomatike Australiane. Shërbimi ETA u mundëson shumë vizitorëve me qëndrim afat-shkurtër në Australi të marrin autorizim për udhëtim në Australi ndërkohë që ata i bëjnë përgatitjet e tyre të udhëtimit. Për shfrytëzuesit e ETA-s, udhëtari nuk ka nevojë që të plotësojë formularin e aplikimit për vizë. Informata të zgjeruara gjenden në faqen e internetit: www.eta.immi.gov.au.

Per te emigruar

Programi Australian i Emigrimit ka tre pjesë:

- **Family migration** (Emigrim Familjar). Aplikanti duhet të ketë një të afërm në Australi që ta sponsorizojë.
- **Skilled migration** (Emigrim sipas Aftësive). Aplikanti duhet të ketë aftësi ose vlera të veçanta të cilat do të kontribuojnë në ekonominë ose në fushat e tjera të jetës Australiane.
- Programet **Refugee, Humanitarian, Special Humanitarian** dhe **Special Assistance** (janë programet për Refugjatë, njerëz që pranohen mbi baza Humanitare, mbi baza Humanitare Speciale si dhe programi për Ndihmë Speciale).

Të afërmit tuaj që duan të emigrojnë duhet t'u përgjigjen kushteve strikte të cilësdo kategori të emigrimit. Rregullat e emigrimit janë komplekse dhe ndryshojnë shpesh, prandaj është mirë të kontaktoni DIAC-n për informacion sipas situatës suaj. Për më shumë informacion shikoni:

Migrating to Australia

www.immi.gov.au/immigration.htm

Një listë e Zyrave Australiane të Emigracionit Jashtë Shtetit ndodhet në faqen e internetit: www.immi.gov.au/contacts/overseas

14. Shërbimet e qeverisë dhe komunitetit Lokal

Australia ka tre sfera qeverisjeje: komonwealth-in, shtetin ose territorin dhe lokalin. Këshillat lokale kujdesen për zonën ku jetoni dhe kryen shërbime të rëndësishme të disponueshme për të gjithë njerëzit e zonës. Këshillat financohen gjerësisht nga pagesat që kryhen nga pronarët lokalë të pronave. Që të keni akses në këto shërbime nuk është e domosdoshme të jeni pronar/e ie një prone.

Shërbimet e Komunitetit

Këshillat lokale shpesh japin lokale publike që të përdoren nga grupe të komunitetit, si ambiente sportive, argëtuese dhe kulturore.

Këshillat mund të sigurojnë gjithashtu një sërë shërbimesh mbështetje si qendrat e shëndetit, qendra për kujdesjen e fëmijëve, punonjës social për të rinjtë si dhe shërbimet për të moshuarit dhe të paaftët.

Shërbime Multikulturore

Shumë Këshilla lokale kanë punonjës multikulturorë ose të komunitetit që mund t'ju japin ndihmë me vlerë dhe këshilla se si të mësoheni me jetën në Australi. Disa kanë shërbime për të plotësuar nevojat në veçanti të nënshtetasve të moshuar me prejardhje të ndryshme kulturore dhe gjuhësore.

Bibliotekat

Shumica e Këshillave mbajnë biblioteka në të cilat njerëzit mund të abonohen dhe të marrin libra hua falas. Bibliotekat kanë ose mund të porosisin libra në gjuhë të ndryshme nga Anglishtja. Në shumicën e bibliotekave ju mund të përdorni edhe internetin.

Shërbime të tjera

Këshillat mbajnë rrugët lokale, WC-të publike, dhe sigurojnë që dyqanet dhe restorantet të kenë standartet e duhura shëndetësore. Ato kontrollojnë zhvillimet ndërtimore, dhe nëse doni të bëni ndonjë ndryshim në pronën tuaj, ju duhet të merrni aprovimin e këshillit lokal.

Këshillat janë përgjegjës për mbledhjen e plehrave dhe reciklimin. Pyetni komunën lokale ose fqinjët për orarin e mbledhjes së mbeturinave.

Më shumë informacion

Vizitoni këshillin tuaj lokal ose bibliotekën lokale për informacion të mëtejshëm mbi shërbimet në lagjen tuaj. Numrat e telefonit dhe adresat e Këshillave shënohen në numërorin telefonik [White Pages](#), nën emrin e zonës lokale që përfshin disa lagje. Mbani mend, se ata janë ekspertët në zonën tuaj lokale! Informacion rreth Qeverisë Lokale gjendet në faqen e internetit: www.gov.au/.